

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi”

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Eglantina Hysa

Prof. Mimoza Kasimati



Qershor 2019

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesionalnë “Administrim Biznesi”(120 ECTS)

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IALAplikues:	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
2	Departamenti/Fakulteti që e ofron	Departamenti i Ekonomisë Fakulteti i Shkencave Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASH nr. 482 datë 03.10.2011 VKA nr. 256 datë 16.09.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të pare	VKA nr. 334 datë 08.06.2012 UMASH nr. 291 datë 11.07.2012
5	Urdhër i riorganizimit	Kërkesa e UMSH, shkresë nr. 246 datë 22.02.2018; Konfirmim nga MASR, shkresë nr. 2042/1 datë 27.03.2018
6	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në “Administrim Biznesi”
7	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
8	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
9	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
10	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	me kohë të plotë
11	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
12	Programi ofrohet vetëm nga institucioni	PO
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	JO
14	Diplomë e përbashkët/ e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Studentët	2017-201857 studentë 2018-201956 studentë

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

Shkurtime	
ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë e Arsimit të Lartë
PS	Program studimi
MPAB	Master Profesional në Administrim Biznesi
DEK	Departamenti i Ekonomisë
DFBK	Departamenti i Finance Banke dhe Kontabilitetit
DIFSH	Departamenti i Informatikes dhe Formimit Shkencor
ECTS	European Credit Transfer and Accumulation System.
FSHE	Fakulteti i Shkencave Ekonomike
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i vlerësimit të jashtëm
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
LALKSH	Ligji për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor
NJSBCZHK	Njësia e Sigurimit të Brendshëm së Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave
PA	Personel akademik
PAE	Personel akademik efektiv
PAK	Personel akademik me kontratë
RVB	Raporti i vlerësimit të brendshëm
RVJ	Raporti i vlerësimit të jashtëm
UMSH	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”
VKM	Vendim i Këshillit Ministrave
ZBNJ	Zyra e Burimeve Njerëzore



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit MP në Administrim Biznesi

PS MPAB është hapur në bazë të Urdhërit 482 datë 03.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe është akredituar për herë të parë në bazë të Urdhërit 291 datë 11.07.2012 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës.

Me qëllim plotësimin e rekomandimeve nga akreditimi i parë (korrik 2012), përshtatjen me ndryshimet e vazhdueshme të tregut universitar dhe të tregut të punës, dhe së fundmi edhe në zbatim të kërkesave të akteve ligjore në fuqi për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi i është nënshtruar përmirësimeve rrënjësore.

Programi është riorganizuar duke kombinuar përvojën e realizimit të tij që nga viti akademik 2012-2013 me tendencat e reja të zhvillimit të tregut të punës si në aspektin sasior, edhe në atë cilësor. Njëkohësisht janë mbajtur parasysh faktorët strukturorë të ndërtimit të një programi të ri për një grup të caktuar studentësh potencialë dhe për pozicione pune të natyrës së administrimit dhe menxhimit në biznesin privat ose në sektorin publik.

MPAB është riorganizuar me vendim të Senatit Akademik të UMSH, datë 4.9.2017, plotësuar me rishikim të planit mësimor konform VKM Nr. 41/ 2018, sipas VSA Nr. 3, dt. 07.02.2018, riorganizim i cili është miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën prot.no 246, dt. 27.03.2018.

Ky PS duke filluar nga viti akademik 2017-18 ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje dy vite akademike, me 120 ECTS.

Ndërtimi i programit të studimit MPAB me 120 ECTS është bërë pasi janë marrë parasysh paraprakisht të gjitha rekomandimet e KA nr. 334, dt. 08.06.2012.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof. Dr. Mimoza Kasimati

Prof. As. Eglantina Hysa

Menaxheri Teknik i vlerësimit të këtij program studimi është specialisti i ASCAL Renata Qatipi

Më datë 11.06.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 131/14 Prot., datë 11.06.2019 “Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, UMSH është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Më datë 18.06.2019, UMSH përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 844/2 Prot., datë 18.06.2019, “Objeksione për Draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit MP në Administrim Biznesi”.

GVJ pasi u njoh me Objeksionet/sqarimet e Institucionit mbi Draft-raportin e vlerësimit për programin e studimit në fjalë, sqaron si më poshtë:

GVJ në Draft RJV – fq. 5/58

- b) Institucioni ka plotësuar pjesërisht rekomandimin “Të realizohet **përmirësimi dhe azhornimi i vazhdueshëm i programeve** të këtyre profileve duke u bazuar në literaturat më bashkëkohore dhe të autorëve të njohur dhe botërorë”

Institucioni ka bërë ndryshime thelbësore në kurrikulën dhe programin e studimit duke reflektuar në syllabusë të reja ose të azhornuara. Megjithëse biblioteka ofron mundësi të literatures online (e gjitha në anglisht),

biblioteka nuk disponon shumë prurje të reja që reflektojnë ndryshimet e mësipërme. Në vitin 2018 janë kërkuar vetëm 11 libra bazë që i përkasin të gjithë Fakultetit të Shkencave Ekonomike.

Objeksion/Sqarim UMSH:

Permiresimi i vazhdueshem i programit eshte realizuar nepermjet ndryshimeve thelbesore ne kurrikulen dhe programin e studimit. Kjo eshte reflektuar ne syllabuse te reja ose te ristrukturuara, me te cilat GVJ eshte njohur dhe i ka vleresuar gjate ketij procesi (Ref RVB fq. 7, pika b) dhe Aneks 7 i RVB- Syllabuset e programit MPAB). Me keto ndryshime institucioni e ka plotesuar teresisht rekomandimin e cituar.

Ne analizen e vleresimit per fondin e librave evidentojme keta elemente qe pasqyrojne rolin e bibliotekes ne mbeshtetje te programit:

- 1. Biblioteka ka nje fond librash qe eshte pasuruar vazhdimisht prej 10 vjetesh. Ne te gjenden pothuajse te gjitha botimet e teksteve universitare ne gjuhen shqipe, nga autore brenda territorit te Shqiperise, qe lidhen me kete program studimi dhe me fusha te tjera te shkencave ekonomike.*
- 2. Dokumenti i referuar per vitin 2018 eshte i fundit kronologjikisht ne procesin e pasurimit te bibliotekes, por jo i vetmi qe mund te evidentonte faktin qe ne biblioteke gjenden te gjitha librat baze te rekomanduara ne te gjitha syllabuset e ketij programi studimi si dhe literatura e rekomanduara ne to si literature ndihmese apo plotesuese. Dokumenti i cituar u vu ne dispozicion te GVJ per te ilustruar praktiken e plotesimit te fondit te librave ne ndihme te programit si procedure dhe jo st argument i vetem per vleresimin e cilesise se programit. Ne kendveshtrimin tone ky dokument, i vetem, nuk mundeson nje gjykim ne lidhje me permiresimin e programit dhe perditësimin e vazhdueshem te literatures, te cilin e deshmojne syllabuset (pjesë e RVB) dhe lista e plote e titujve te bibliotekes, e cila mund te ishte vene ne dispozicion te GVJ, nese do te kerkohej, sikurse ndodhi per evidenca dhe dokumente te tjere. Nga ai dokumentacion evidentohet se shtesa mesatare vjetore e fondit te librave ne 5 vitet e fundit ka qene shume me e madhe.*

Përgjigje e GVJ: Paragrafi mbetet i pandryshuar.

Objeksioni i Institucionit nuk mbështetet në evidence shtesë. Azhornimi dhe ndryshimet thelbesore që kanë ndodhur në programin MPAB nuk reflektohet mjaftueshëm në pasurim të literatures përkatëse.

GVJ në Draft RJV – fq. 12/58

Këshilli Shkencor i Programit përbëhet nga 3 persona, personel akademik me grada e tituj shkencorë. Nga këta, të paktën njëri është direkt i përfshirë në mësimdhënie në këtë PS sipas tabelave 1; 2; dhe 4 në Aneksë.

Gjithashtu jepet edhe Komisioni i përhershëm i FSHE (Tabela 3.6, në Aneks), me 7 anëtarë, njëri student dhe gjithë të tjerët të kategorisë Profesor, ku afërsisht gjysma janë mësimdhënës në këtë PS.

Objeksion/Sqarim UMSH:

Ne aspektin kronologjik keto struktura nuk kane bashkeekzistuar, por kane zevendesuar njera-tjetren si me poshte:

- Keshilli Shkencor i Programit ka funksionuar deri ne vitin akademik 2016-2017, ne zbati te kerkesave ligjore per Arsimin e Larte ne fuqi deri ne ate periudhe. Ky Keshill dhe aktiviteti i tij lidhet me programin e studimit Master Profesional ne Administrim Biznesi, me 90 ECTS dhe kohezgatje 1,5 vjet, qe nuk zhvillohet me.*
- Qe nga viti akademik 2017-2018 eshte krijuar dhe funksionon Komisioni i Perhershem i FSHE, ne perputhje me LALK.SH 80/2015 dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij. Aktiviteti i ketij Komisioni lidhet me programin MPAB qe vleresohet.*

Te dyja keto struktura kane plotesuar kerkesat ligjore ne fuqi ne kohen e funksionimit te tyre.

Përgjigje e GVJ: Do te ndryshoje teksti ne raport në:

Komisioni i përhershëm i FSHE që i shërben PS MPAB 120 ECTS, i krijuar në vitin akademik 2017-18 sipas normave të Ligjit 80/2015 përbëhet nga 7 anëtarë, njëri student dhe gjithë të tjerët të kategorisë Profesor, ku afërsisht gjysma janë mësimdhënës në këtë PS (Tabela 3.6, në Aneks).

GVJ në Draft RJV – fq. 17/58

Megjithëse cdo staf akademik ka tavolinën dhe kompjuterin personal, nga vizita në këto ambiente u vu re që hapsira e këtyre ambienteve është e vogël në krahasim me numrin e stafit akademik. E njëjta situatë u vu re dhe në ambientet e zyrave të stafit administrativ. Psh, zyra e pranimit dhe e sekretarise, e cila duhet të jetë në shërbim të studentëve dhe stafit akademik, paraqet një hapësirë shumë të limituar ku qëndrojnë 5 personel administrativ dhe ku ka vizitorë të shumtë.

Sqarim UMSH:

Kendveshtrimet vizuale të ambienteve mund të krijojnë pershtypje të ndryshme në persona të ndryshëm, sepse konceptimet arkitektonike janë personale dhe shpesh kushtezohen edhe nga eksperiencia personale. Cdo vit institucioni ynë para konfirmimit të kuotave vjetore nga MASR kalon procesin e verifikimit të kuotave dhe kapaciteteve dhe deri tani nuk është evidentuar për kuotat e këtij fakulteti mungesa e normativave të siperfaqes në aspektin funksional (persona për m2).

Kjo nuk do të thote se nuk ekziston një plan investimesh për të rritur cilësinë e ambienteve në të ardhmen. Është një proces i vazhdueshëm dhe me zë me vehte në buxhetin e zhvillimit institucional, por aktualisht nuk preken standartet e punës. Me tej akoma sekretaria ka në dispozicion edhe dy zyra - njëra e programit master si dhe një tjetër për perpunimin e informacioneve dhe regjistrave në katin -1. Sekretaria punon në mënyrë të alternuar në pritje, në punë të pavarura, si dhe janë të zhvendosura në kohe gjate gjithë orareve të punës në UMSH (pra në të shumtën e kohës nuk janë të gjitha në të njëjtin ambient sic referohet).

Përgjigje GVJ: Paragrafi mbetet i pandryshuar.

Konkluzioni i mësipërm u nxorr nga vizita e grupit të eksperteve në zyrat përkatëse. Objeksioni/sqarimi nga ana e institucionit nuk i vjen në ndihmë konstatimit thënë më sipër.

GVJ në Draft RJV – fq. 18/58

Megjithëse biblioteka e institucionit përmban tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse, kjo literaturë duket jo e mjaftueshme për disa lëndë specifike të programit. Kjo konfirmohet dhe nga takimi me studentët dhe kërkesa e tyre për të patur libra të integruar specifikisht me programin e studimit;

Institucioni mbështet kërkesën për shtimin e zërave të bibliotekës. Në lidhje me shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike në Nëntor 2018 propozon një listë prej 11 titujsh të librave bazë (te cilat janë për të gjitha programe bachelor dhe master të këtij fakulteti);

Orare të shërbimit të bibliotekës janë të shpallur në hyrje të bibliotekës. Biblioteka qëndron e hapur gjatë javës 08.00-17.00 dhe të shtunën paradite.

Objeksion/Sqarim UMSH:

1. *Per disponibilitetin dhe plotesimin e nevojave per literature per lendet e ketij programi ne vecanti dhe të programeve të fushës ekonomike në përgjithësi, i referohemi saktësisht me lart, pika RVJ - fq. 5/58.*

2. *Biblioteka ka një fond librash që është pasuruar vazhdimisht prej 10 vjetësh. Në të gjenden pothuajse të gjitha botimet e teksteve universitare në gjuhën shqipe, nga autore brenda territorit të Shqipërisë, që lidhen me këtë program studimi dhe me fusha të tjera të shkencave ekonomike. Në bibliotekë gjenden të gjithë librat bazë*

te rekomanduar ne te gjithë syllabuset e këtij programi studimi si dhe literatura e rekomanduar ne to si literature ndihmese apo plotesuese.

3. Ne lidhje me orarin e funksionimit të saj, Biblioleka është e hapur gjate gjithë kohes qe UMSH është hapur (E hene, 08:00-17:00, E marte - E premte 08:00-20:00 dhe E shtune 08:00-16:00)

Përgjigje e GVJ: Paragrafi ndryshon në:

Megjithëse biblioteka e institucionit përmban tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse, kjo literaturë duket jo e mjaftueshme për disa lëndë specifike të programit. Kjo konfirmohet dhe nga takimi me studentët dhe kërkesa e tyre për të patur libra të integruar specifikisht me programin e studimit;

Institucioni mbështet kërkesën për shtimin e zërave të bibliotekës. Në lidhje me shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike në Nëntor 2018 propozon një listë prej 11 titujsh të librave bazë (te cilat janë për të gjitha programe bachelor dhe master të këtij fakulteti);

Orare të shërbimit të bibliotekës janë të shpallur në hyrje të bibliotekës. Biblioteka qëndron e hapur të hënën 08.00-17.00, të martë-të premte 08.00-20.00 dhe të shtunën 08.00-16.00.

GVJ në Draft RJV – fq. 19/58

Nga sa u konstatua mësipër, grupi i vlerësimit sugjeron që të rritet larmishmëria e librave në bibliotekë, të cilat duhet të përfshijnë jo vetëm disa libra bazë të lëndëve por dhe librat mbështetës që gjenden në syllabuset e secilës lëndë. Duke qënë se biblioteka është në katin -1, ky ambient nuk është i pajisur me dritare, gjë e cila është pengesë për një tërheqje sa më të lartë të studentëve në sallën e leximit. Oraret e bibliotekës janë të limituara, megjithate studentët mund ta përdorin atë ditën e shtunë. Sugjerohet që orari i bibliotekës të shpallet edhe në web-in e institucionit.

Objeksion/Sqarim UMSH:

Vendosja e bibliotekes ne katin -1 është shoqeruar me instalimin e sistemit te ajrimit, kondicionimit dhe ndricimit qe e ben ate plotesisht komod per studentet dhe te interesuarit e tjere per pune duke plotesuar te gjitha kerkesat e standardeve per ndricim dhe ajrim si dhe larg levizjeve te vazhdueshme ne institucion duke krijuar ambientin e qete te nevojshem per lexim ... Gjithashtu ambienti është i pajisur me dritare duke mundesuar edhe ajrim natyral. Sikurse u permend me lart, Biblioteka është e hapur gjate gjithë kohes qe UMSH është hapur (E hene, 08:00-17:00, E marte - E premte 08:00-20:00 dhe E shtune 08:00-16:00).

Përgjigje e GVJ: Paragrafi ndryshon në:

Nga sa u konstatua mësipër, grupi i vlerësimit sugjeron që të rritet larmishmëria e librave në bibliotekë, të cilat duhet të përfshijnë jo vetëm disa libra bazë të lëndëve por dhe librat mbështetës që gjenden në syllabuset e secilës lëndë. Duke qënë se biblioteka është në katin -1, ky ambient nuk është i pajisur me dritare, gjë e cila është pengesë për një tërheqje sa më të lartë të studentëve në sallën e leximit. **Oraret e bibliotekës janë të mjaftueshme.** Sugjerohet që orari i bibliotekës të shpallet edhe në web-in e institucionit.

GVJ në Draft RJV – fq. 20/58

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i mendimit se bazimi i burimeve financiare në pothuaj tërësisht në tarifatat studentore e bën universitetin shumë të ndjeshëm ndaj regjistrimeve vjetore të studentëve. Kjo bën që universiteti të ketë vështirësi në parashikimet e investimeve si dhe të strategjive afatgjata.

Objeksion/Sqarim UMSH:

- Pasqyrat financiare te Institucionit hartohen sipas standarteve kombetare te kontabilitetit dhe. pasqyrojne me saktesi gjendjen financiare te tij, gjendje e cila jep siguri per vazhdimesine e aktivitetit te institucionit.
- GVJ nuk kerkoi te njihej me keto pasqyra, prej nga do te mund te gjykonte nese ka risk per veshtiresi ne parashikimet e investimeve dhe te strategjive afatgjata, si edhe per masen e ketij risku Si ne vleresimin e punes shkencore, ashtu dhe ne analizen e infrastruktures eshte evidentuar fakti se rritja e investimeve dhe shpenzimeve ka qene shume e konsiderueshme. .
- Njekohesisht tek analiza e punes me studentet eshte evidentuar fakti se kemi nje rritje konstante te dhenies se bursave per studentet per cdo vit (mbi 30% e te ardhurave nga tarifat jepet per bursa per cdo vit akademik, shume e cila edhe ne vlere absolute rritet ne menyre te konsiderueshme duke pasur parasysh edhe rritjen e numrit te studenteve.

Gjendja e depozite (70% e shpenzimeve vjetore) si dhe shuma e pervitshme e bursave perbejne elemente te qarte te shendetit ekonomik te institucionit duke lejuar edhe planifikimin e investimeve dhe zbatimin e strategjive afatgjata. Diversifikimi i burimeve eshte pjese e strategjise institucionale duke nxitur pjesemarrjen ne projekte kerkimore e shkencore dhe sherbime ndaj te treteve. Per kete te fundit, ne kuadrin e statusit te organizates Jo per fitim, UMSH eshte angazhuar ne bashkepunime te ndryshme me shoqata duke ofruar kontributin e tij pa pagese.

Përgjigje e GVJ: Paragrafi ndryshon në:

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i mendimit se bazimi i burimeve financiare në pothuaj tërësisht në tarifat studentore e bën universitetin shumë të ndjeshëm ndaj regjistrimeve vjetore të studentëve. ***Kjo bën që parashikimet e investimeve si dhe strategjitë afatgjata të jenë të varura nga ky tregues.***

GVJ në Draft RJV – fq. 21/58

Megjithëse grupi i ekspertëve kërkoi të dhëna të plota për 6 vitet e fundit, institucioni ofroi vetëm të dhëna në lidhje me dy vitet e fundit.

Gjatë vizitës në institucion, ekspertët e vlerësimit kërkuan pjesën përmbledhëse të raportit të auditit. Dokumenti që na u ofrua nuk përmbante një konkluzion që do na vinte në ndihmë nëse audit i jashtëm është shprehur për një qëndrueshmëri të situatës financiare së këtij institucioni.

Objeksion i UMSH:

- *Ky program studimi 2-vjeçar, me 120 ECTS, qe ka nisur realizimin ne vitin akademik 2017-2018 eshte ne ciklin e pare te tij. Dokumentacioni shoqerues i RVB perfshin te gjitha te dhenat sipas formatit standard te vleresimit per here te pare te programit, ne te cilin tabelat jane plotesuar per te gjitha vitet e funksionimit te ketij programi (2 vjet).*
- *Grupit te eksperteve, me kerkesen e tyre, ju vune ne dispozicion edhe te dhena per 5 vitet akademike (2012-2013 deri 2016-2017) ne te cilet zhvillohej programi i meparshem MPAB me 90 ECTS, 1,5 vjet. Te dhenat ishin per te gjitha rubrikat qe kerkoi GVJ gjate vizites ne institucion, nder te cilat nuk perfshihej fusha 5.*
- *Raporti i Auditimit konfirmon sigurine ne vazhdimesine e aktivitetit ne formen qe eshte paraqitur. Sipas standarteve te auditimit (te detyrueshme per zbatim ne RSH), raporti i auditimit leshohet vetem per subjekte juridike qe krijojne siguri per vazhdimesine e aktivitetit te tyre. Standartet kerkojne qe Audituesi te shprehet ndryshe vetem ne rastet e dyshimeve dhe risqeve te larta duke vendosur fjalet ME REZERVE, ose NUK SIGURON VAZHDIMESINE, ose heq dore dhe nuk jep opinion.*

Përgjigje e GVJ: Paragrafi ndryshon në:

Megjithëse grupi i ekspertëve kërkoi të dhëna të plota për 6 vitet e fundit, institucioni ofroi vetëm të dhëna financiare në lidhje me dy vitet e fundit (pra ato që janë dhe në RVB).

Gjatë vizitës në institucion, ekspertët e vlerësimit kërkuan pjesën përmbledhëse të raportit të auditit. Dokumenti që na u ofrua ishte i përgjithshëm dhe nuk përmbante shumë detaje.

GVJ në Draft RJV – fq. 22/58

....vihet re një ndryshim i shpeshtë i anëtarëve të NJSBCZHK. Anëtarët më të vjetër janë të vitit 2017-2018 dhe më të rinjtë 2018-2019.

Sqarim UMSH:

Sqarojme se me miratimin e statusit universitet të institucionit tone në maj 2017, të gjitha njesite perberese te UMSH, u riorganizuan ne pershtatje te statusit te ri te tij dhe qe shenon fillimin e punes si të riorganizuara, perfshire rastin e NJSBCZHK ne 2017. Keshtu qe sqarojme se nuk kemi te bejme me ndryshim te anetareve te NJSBCZHK ,por me riorganizim te kesaj njesie. Ne vitin 2018 ne funksion te arritjes se objektivave tij te zgjerimit dhe permiresimit te vazhdueshem te cilesise, insitucioni e ka pare te arsyeshme qe organigrama e kesaj njesie te zgjerohet, ne menyre qe te mos krijohen ngarkesa të teperta per anetaret ne proceset qe kjo njesi duhej te perfshihej pergjate gjithe vitit, ne perputhje me planin e punes se njesise ne realizimin e politikave institucionale.

Përgjigje e GVJ: Paragrafi mbetet i pandryshuar.

Sqarimi mbështet atë çfarë është thënë dhe nga GVJ.

GVJ në Draft RJV – fq. 23/58

Faqja zyrtare e institucionit nuk përmban informacione në lidhje me vlerësimin e brendshëm. I vetmi informacion i gjetur në faqen e internetit janë raportet e vlerësimeve të jashem për pesë programe studimi të akredituara vitin e fundit.

Objeksion/Sqarim UMSH:

Raportet e NJSBCZHK jane te hapura dhe transparente dhe u behen me dije te gjithe anetareve te stafit akademik dhe administrativ nepermjet drejtuesve te tyre. Strategjite dhe qellimet e institucionit behen te aksesueshme nga te gjithe jo vetem nga faqja zyrtare, por edhe nepermjet broshurave qe u shperndahen mbare publikut pergjate periudhave te rekrutimit te studenteve te rinj. Strategjite dhe politikat e institucionit behen te aksesueshme edhe nga personat e interesuar per te qene pjese e rekrutimeve te reja te stafit akademik.

Strategjite dhe politikat u behen me dije te gjithe anetareve te stafit ne mbledhjet e hapura qe realizohen ne menyre peridodike.

Përgjigje e GVJ: Paragrafi mbetet i pandryshuar.

Objeksionet/sqarimet e institucionit nuk hedhin poshtë konstatimin që faqja zyrtare e UMSH nuk përmban informacione në lidhje me vlerësimin e brendshëm.

GVJ në Draft RJV – fq. 24/58

Megjithëse NJSBCZHK ka riorganizuar më së fundmi disa mënyra vlerësimi në rang programi, nuk mund të themi se institucioni ka një strategji të përgjithshme të shkruar për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Objeksion UMSH:

Plani strategjik i UMSH, dokument shoqerues i RVB, i vene ne dispozicion te ketij vleresimi, ka percaktuar Objektivat Strategjike te institucionit per 5 vitet e ardhshme, nder te cilet Objektivi 2 i dedikohet permiresimit te vazhdueshem te cilesise (Ref Aneks IV ne profilin e UMSH-Strategjia e Zhvillimit te Institucionit 2018-2023, OS2, fq. 10-12).

Përgjigje e GVJ: Paragrafi ndryshon në:

Institucioni në planin strategjik 2018-2023 ka parashtruar një strategji të detajuar në lidhje me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë (Objektivi 2, fq. 10-12). NJSBCZHK ka riorganizuar më së fundmi disa mënyra vlerësimi edhe në rang programi.

GVJ në Draft RJV – fq. 27/58

Megjithatë një nga barrierat e këtij programi është që programi behet në shqip, ndaj ndërkombëtarizimi i tij (programet e shkëmbimit, shkëmbimet e profesorëve të huaj, etj.) është i vështirë. Grupi i jashtëm i vlerësimit sugjeron që këtij programi ti shtohet dhe një lëndë e profilit, si psh. “Business English”.

Objeksion/Sqarim UMSH:

Sikurse kerkon Standardi 1.5, ky PS synon te arrije dimensione nderkombetare duke u bere nderkombetarisht konkurrues ne radhe te pare me permbajtjen e tij, njohurite qe ju ofron studenteve; me tej me mundesite e transferimit te krediteve dhe lehtesimin e shkembimeve. Duke qene nje program i organizuar e i miratuar per realizim ne gjuhen shqipe dhe i natyres Master Profesional, ne ciklin e pare te tij eshte fokusuar ne konsolidimin si i tille. Paralelisht, dhe ne kuadrin e zbatimit te strategjise se pergjithshme te UMSH per nderkombetarizimin, edhe per kete program ka filluar puna dhe ai eshte perfshire ne marreveshje konkrete me institucione akademike nderkombetare (Ref RVB fq. 60; fq. 62, cituar me poshte), pa e mbyllur ende kete cikël te pare.

Përgjigje GVJ: Paragrafi mbetet i pandryshuar.

Objeksioni/sqarimi nga ana e institucionit është në një linjë me sugjerimin e thënë mësipër.

GVJ në Draft RJV – fq. 29/58

Grupi i vlerësimit të jashtëm sugjeron që institucioni duhet të ofrojë publikimin e detajuar të programit mësimor, ku të shfaqen të gjithë lëndët bashkë me brendësinë e tyre.

Objeksion/Sqarim UMSH:

Te gjitha programet e studimit te organizuara ne UMSH jane te publikuara me detaje dhe me te gjithe elementet ne disa forma: Ne faqen e UMSH ku tashme, po punohet qe aksesibiliteti te jete me i thjeshtezuar; ne llogarite individuale te studenteve ne SMS; ne dosjen me te cilen studentet pajisen gjate regjistrimit te tyre; ne te gjitha fletepalosjet informuese qe mund te gjenden si brenda UMSH ne zyren e Informacionit te Studenteve, por edhe jashte si pjese e fushates se informimit.

Përgjigje GVJ: Paragrafi mbetet i pandryshuar.

GVJ nuk konstatoi evidenca që programi mësimor është në faqen zyrtare të institucionit.

GVJ në Draft RJV – fq. 30/58

Duke vlerësuar programin dhe lëndët e ofruara, grupi i vlerësimit të jashtëm sugjeron:



1. *Ndërkombëtarizimin e programit. Një nga elementët fillestare mund të jetë shtimi i një lënde të re (e detyruar) si "Business English" ose një lënde tjetër alternative, e cila do të ndihmojë në rritjen e kapaciteteve gjuhësore si dhe në mundësinë e studentëve për të qenë pjesë e programeve të shkëmbimit që mund të ofrohen në të ardhmen;*
3. *Institucioni duhet të marrë masa të publikojë të gjithë programin e studimit bashkë me syllabuset përkatëse në faqen zyrtare të tij. Kjo do të ndihmojë në informimin më efikas të të interesuarve për këtë program studimi.*

Objeksion/Sqarim UMSH:

Per Rekomandimin nr. 1 i referohemi saktësisht me lart, pika RVJ - fq.27/58, i cili sqaron plotësimin e kërkesave të standardit 1.5 dhe angazhimin e institucionit për ta tejkaluar atë. Vete institucioni e ka evidentuar këtë si objektiv të zhvillimit të mëtejshëm të programit (ref RVB, fq. 75).

Per Rekomandimin nr.3 i referohemi saktësisht me lart, pika RVJ-fq.29/58.

Përgjigje GVJ: Paragrafi mbetet i pandryshuar.

Objeksioni/sqarimi nga ana e institucionit është në një linjë me sugjerimin 1. Gjithashtu për pikën 3, nuk ka një evidencë që faja zyrtare përmban detajet e programit.

GVJ në Draft RJV – fq. 31/58

Gjithashtu studentë aktivizohen në Zyrën e karrierës dhe një student ishte pjesë e GVB (jo nga ky PS).

Objeksion/Sqarim UMSH:

Studenti anetar i GVB, Herald Xhafa, është student nga ky program studimi, në vitin e dytë. Përzgjedhja e tij si pjesë e GVB ka qenë e mbështetur në aktivizimin e tij në Zyrën e Karrierës.

Përgjigje e GVJ: Po, OK. Mund të jetë një lapsus gjatë komunikimit. Nuk ka arsye për të menduar të kundërtën e asaj që deklaron institucioni. Komenti në kllapa në fjalinë e mësipërme do të hiqet.

GVJ në Draft RJV – fq. 34/58

Studentëve u jepet informacion mbi statusin e institucionit dhe të PS në lidhje me akreditimin dhe njohjen e diplomës në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Ky informacion duhet të bëhet publik nga institucioni në adresën elektronike www.umsh.edu.al – Sigurimi i cilesise.

Në RVB thuhet që: Informacioni për PS, afatet/kalendaret, statusin e akreditimit, dhe organizimin ju vihet në dispozicion studentëve në portalin e institucionit. Nga verifikimi i GVJ ky proces ka boshllëqe.

Objeksion/Sqarim UMSH:

Ne lidhje me citimin e RVB Informacioni për PS, afatet/kalendaret, statusin e akreditimit, dhe organizimin ju vihet në dispozicion studentëve në portalin e institucionit ... , theksojmë edhe njëherë që ky është informacion i aksesueshem për studentet:

- *nepermjet faqes zyrtare të institucionit dhe rrjeteve sociale të tij, ku njoftohen aktet ligjore e nenligjore që shpallin afatet e regjistrimeve dhe fillimit të vitit, si dhe kalendari akademik;*
- *ne llogarite e tyre. individuale në SMS dhe në njoftimet që hën sekretaria për çdo student (edhe në sms)*

- gjithashtu është pjesë e materialeve të dosjes me të cilën studentet pajisen gjatë regjistrimit të tyre dhe e Udhezuesit të studentit & raportit të performancës, pjesë e kontratës së studentit.

Përgjigje e GVJ: Po, pikërisht, komentet sqaruese të institucionit mbështesin komentin e bërë nga RVJ në kuptimin që ka pasur RVJ në këtë fjali. Duke mirëkuptuar komentet e institucionit, kuptojmë që fjalia mund të kuptohet jo sic ka qënë në mëndjen e shkruarit, kështu që: fjalia Nga verifikimi i GVJ ky proces ka boshllëqe do të ndryshohet në: Nga verifikimi i GVJ konstatohet se informacioni në faqen elektronike/portalin duhet të jetë më i plotë, për të dhënë mundësi për vlerësim të pavarur nga cilido përdorues i interesuar/ student potencial. (sepse ky ishte në fakt edhe kuptimi/qëllimi i fjalisë që do ndryshohet).

GVJ në Draft RJV – fq. 38/58

Ndërkohë, marrëveshjet ndërkombetare që institucioni ka nuk janë efektive për Programin Profesional të Administrimit të Biznesit.

GVJ në Draft RJV – fq. 39/58

Shihet qartë që institucioni ka realizuar disa marrëveshje me aktorë vendas të cilat dhe janë funksionale. Megjithatë për momentin nuk ka ndonjë marrëveshje konkrete me institucione të huaja që janë në ndihmë të procesit mësimor ose të praktikave profesionale në këtë program studimi;

Objeksion/Sqarim UMSH:

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm citon të paktën një marrëveshje konkrete me institucion të huaj akademik që është në proces zbatimi lidhur me mobilitetin e stafit dhe të studenteve në ndihmë të këtij programi studimi (RVB fq.50- "Vend të vecante ze bashkëpunimi me Universitetin e Shkencave Sociale të Lodz (Poloni), në të cilin janë përcaktuar termat konkrete për mobilitetin e studenteve dhe stafit në programet Bachelor dhe Master në fushën e Administrimit të Biznesit." dhe RVB fq. 62- "Realizimi i bashkëpunimit me Universitetin e Shkencave Sociale të Lodz (Poloni), referuar me lart në Standardin I.5, do të kontribuojë në realizimin e këtij objektiv gjatë periudhës 2019-2021"

Keto fakte, që deshmojnë se procesi ka filluar, janë bërë të njohura për GVJ në takimet gjatë vizitës në institucion. Pa dyshim institucionit i takon t'i shtojë dhe bëjë sa më të frytshme keto bashkëpunime, objektiv për të cilin po punon.

Përgjigje e GVJ: Paragrafi mbetet i pandryshuar.

Objeksioni/sqarimi nga ana e institucionit mbështet çfarë është thënë mësipër. Për momentin nuk ka një marrëveshje të shkruar në lidhje me programin e studimit.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

Me VKA nr. 334, dt. 08.06.2012 UMSH i ishte rekomanduar si vijon:

- Të shikohet në të ardhmen mundësia e rritjes së numrit të pedagogëve me kohë të plotë dhe me grada e tituj shkencorë.
- Të realizohet përmirësimi dhe azhurnimi i vazhdueshëm i programeve të këtyre profileve duke u bazuar në literaturat më bashkëkohore dhe të autorëve të njohur dhe botërorë;
- Të bëhet shumë promovim për tërheqjen në këto profile studimi të studentëve të rinj me rezultate të larta nga sistemi i studimeve Bachelor, me qëllim që të investohet shumë tek ata dhe të bëhen në të ardhmen lidera përkatësisht në fushat e administrim biznesit dhe të administratës publike;
- Të shihet mundësia që në semestrin e dytë të studimeve master të përfshihen të paktën dy lëndë me zgjedhje, praktikë e hasur në shumë universitete të njohura botërore;
- Të hartohet një plan i përgjithshëm strategjik 10-20 vjeçar, dhe i detajuar në periudha afatmesme e afatshkurtra për zhvillimin e institucionit dhe për të parashikuar ndryshimet e ndryshme që mund të ndodhin e për t'i bërë ballë konkurrencës së vazhdueshme nga universitete të tjera të vendit qofshin këto publike apo private.
- Të sigurohet që studentët e këtij programi studimit duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.


II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- Institucioni ka plotësuar rekomandimin “Të shikohet në të ardhmen mundësia e rritjes së numrit të pedagogëve me kohë të plotë dhe me grada e tituj shkencorë”.

Nga përmbledhja e të dhënave të ofruara prej institucionit (Tabelat 1.1-1.7 dhe 2.1-2.7), GVJ prodhoi tabelën dhe grafikun bashkëngjitur ku qartazi duket kujdesi i institucionit për të shtuar numrin e PAE dhe të atij me grada e tituj që nga viti 2012 si në rang fakulteti edhe departamentesh.

FSHE	PAE 2018-19		PAE 2017-18		PAE 2016-17		PAE 2015-16		PAE 2014-15		PAE 2013-14		PAE 2012-13	
	Gjithsj	T/G	Gjithsj	T/G	GJ	G/T	GJ	G/T	GJ	G/T	GJ	G/T	GJ	G/T
DEK	16	10	13	4	10	5	7	3	8	4	7	2	7	2
DIFSH	13	5	12	5	12	6	11	6	10	3	NA	NA	NA	NA
DFBK	11	4	14	5	8	5	9	4	7	4	7	3	7	3
Tot PAE	40	19	39	14	30	16	27	13	25	11	14	5	14	5

Fakulteti i shkencave ekonomike



Departamenti i Ekonomisë, përgjegjës për PS MPAB 120 ECTS, ka në përbërje 16 PAE, nga të cilët 10 me grada e tituj shkencorë, dhe 5 pedagogë me kontratë. Personeli akaedmik i shtuar është synuar me grada e tituj, me grada shkencore të fituara në universitete jashtë vendit, dhe me përvojë në mësimdhënie. Një pjesë e pedagogëve të FSHE janë të angazhuar në këtë program që në fillimet e tij, gjë që ka ndikuar në konsolidimin dhe garantimin e qëndrueshmërisë së programit.

PS MPAB i riorganizuar me 120ECTS, që përfshin 14 veprimtari formuese (sipas klasifikimit me A-E, referuar VKM nr. 41, dt.24.01.2018), mund të realizohet plotësisht nga pedagogë efektivë, me grada dhe tituj shkencorë, në Departamentine ekonomisë dhe nëdepartamentet e tjera me të cilat bashkëpunohet për këtë PS. Kapacitetet ekzistuese evidentohen në tabelat nr. 1, nr. 2, nr. 4 në RVJ. Ato mund të verifikohen edhe në syllabuset e lëndëve të ofruara nga institucioni.

- b) Institucioni ka plotësuar pjesërisht rekomandimin “Të realizohet **përmirësimi dhe azhornimi i vazhdueshëm i programeve** të këtyre profileve duke u bazuar në literaturat më bashkëkohore dhe të autorëve të njohur dhe botërorë”

Institucioni ka bërë ndryshime thelbësore në kurrikulën dhe programin e studimit duke reflektuar në syllabuse të reja ose të azhornuara. Megjithëse biblioteka ofron mundësi të literatures online (e gjitha në anglisht), biblioteka nuk disponon shumë prurje të reja që reflektojnë ndryshimet e mësipërme. Në vitin 2018 janë kërkuar vetëm 11 libra bazë që i përkasin të gjithë Fakultetit të Shkencave Ekonomike.

- c) Institucioni ka plotësuar rekomandimin “Të bëhet shumë **promocion për tërheqjen** në këto profile studimi të **studentëve të rinj me rezultate të larta** nga sistemi i studimeve Bachelor, me qëllim që të investohet shumë tek ata dhe të bëhen në të ardhmen lidera përkatësisht në fushat e administrim biznesit dhe të administratës publike”

GVJ vëren se Rekomandimi i KA ashtu sic është formuluar, është kufizues për qëllimin/vizionin e PS MPAB 120 ECTS.

Institucioni ka punuar për përmbushjen e këtij rekomandimi duke bërë fushatapromocionale tek studentët që diplomohen në ciklin e parë në këtë universitet, duke i ftuar që të ngrenë në një nivel më të lartë përgatitjen profesionale dhe frymën sipërmarrëse nëpërmjet regjistrimit në PS MPAB 120 ECTS. Meqenëse në fokus të këtij program janë aftësi që i nevojiten drejtuesit të nivelit të ulët e të mesëm të biznesit privat (shitje, organizim prodhimi, manaxhimi projekteve, manaxhimit i investimeve, lidërsip), UMSH ka promovuar PS MPAB 120 ECTS në të gjitha organizatat e biznesit me të cilat ka marrëdhënie bashkëpunimi. Meqenëse ky PS ka në thelb stimulimin e vendimmarrjes nëpërmjet gjykimit të shifrave duke nxitur iniciativën vendimmarrëse, ky PS shërben edhe për drejtues të pushtetit qëndror e vendor dhe si i tillë është promovuar edhe në AP. Institucioni është i angazhuar që pas ciklit të parë të funksionimit dhe brezit të parë të studentëve të diplomuar të rishikojë politikën e promocionit për këtë program dhe të evidentojë përmirësimet e mundshme.

- d) Institucioni ka plotësuarplotësisht rekomandimin “Të shihet mundësia që në semestrin e dytë të studimeve master **të përfshihentë paktën dy lëndë me zgjedhje**, praktikë e hasur në shumë universitete të njohura botërore”.

Institucioni ka shtuar në programin e tij 2 lëndë me zgjedhje për semestrin e dytë të secilit vit akademik.


- e) Institucioni ka plotësuar rekomandimin “Të hartohet një **plan i përgjithshëm strategjik 10-20 vjecar, dhe i detajuar** në periudha afatmesme e afatshkurtra **për zhvillimin e institucionit** dhe për të parashikuar ndryshimet e ndryshme që mund të ndodhin e për t'i bërë ballë konkurrencës së vazhdueshme nga universitete të tjera të vendit qofshin këto publike apo private”

Në mbështetje të RVB institucioni ka ofruar edhe dokumenta të ndryshme rregulluese. Ndër to është Strategjia e zhvillimit të institucionit 2018-2023”. Kjo strategji mbështet edhe PS MPAB 120 ECTS. Pas realizimit të një

cikli të plotë të tij, institucioni parashikon mundësinë e përmirësimit të këtij produkti universitar, në përputhje me kapacitetet e institucionit.

f) Institucioni ka plotësuar rekomandimin “Të sigurohet që **studentët e këtij programi studimit duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze**, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare”.

Institucioni ka realizuar këtë detyrim për të diplomuarit në programin MPAB 90 ECTS, në zbatim të Udhëzimit nr. 14, datë 28.03.2011 (plus shtojca), LALKSH 80/2015 dhe udhëzimit Nr. 62 të MASR datë 03.12.2015. PS MP AB (120 ECTS) gjithashtu e ka të detyruar dhënien e provimit të gjuhës angleze në zbatim të legjislacionit në fuqi.



1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Referuar RVB, Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” (UMSH) është një institucion jofitimprurës i arsimit të lartë që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë. Ai është projekt i Qendrës Mesdheu, themeluar në 2007 nga një grup intelektualësh, profesorësh dhe ekspertësh me eksperiencë në fushën akademike dhe të kërkimit shkencor. UMSH filloi aktivitetin në vitin 2009, me VKM Nr. 177/2009 që lejoi hapjen e institucionit “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”. Në vazhdimësi janë hapur dhe akredituar programet e studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë. Aktualisht funksionon si universitet, në bazë të Urdhërit Nr. 273 datë 18.05.2017 të MASR për miratimin e ristrukturimit dhe përbëhet nga tre fakultete: Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike. UMSH në secilin prej fakulteteve ofron programe studimi të Ciklit të Parë "Bachelor", të Ciklit të dytë "Master i Shkencave" dhe "Master Profesional" dhe pasi ka aplikuar për programin e studimeve në ciklin e tretë është në pritje të akteve nënligjore që rregullojnë këtë veprimtari. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” është akredituar institucionalisht dhe riakredituar në vitin 2017.

Vizioni i institucionit është tëshndërrohet në një universitet lider për zhvillimin dhe përhapjen e dijes në shoqërinë shqiptare, një qendër dhe burim ekselence në formimin akademik të studentëve, për përgatitjen e specialistëve dhe kërkuesve të rinj, një qendër ekspertize dhe kërkimi të specializuar shkencor në fushën e studimeve shoqërore-politike, ekonomike e juridike në vend, me ndikim në rajon e më gjerë. *Misioni* i institucionit për një edukim cilësor dhe të qëndrueshëm të studentëve, në shërbim të dijes së shoqërisë shqiptare, zbatohet duke krijuar, zhvilluar dhe transmetuar njohuritë nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në funksion të përditësimit dhe zgjerimit të bazës teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve dhe ofrimit të shërbimeve.

Fakulteti i Shkencave Ekonomike (FSHE),filloi aktivitetin në vitin 2009 me një program të ciklit të parë. Në vite, është rritur në aspektin sasior dhe cilësor. Kjo konkretizohet nërritjen e numrit tëprogrameve të studimit (PS), të personelit akademik me grada e kualifikime që angazhon në mësimdhënie e kërkim shkencor dhe të numrit të të diplomuarve. FSHE në Ciklin e Parë "Bachelor" ofron programin e studimit Shkenca Ekonomike me profile (Financë Bankë dhe Kontabilitet, Administrim Biznesi, Biznes dhe Ligj) dhe programin Informatikë Biznesi. Në Ciklin e Dytë të studimeve ofron programet “Master i Shkencave në Financë Bankë”, “Master i Shkencave në Sisteme Informacioni në Biznes”; “Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes”, “Master Profesional në Administrim Biznesi” dhe “Master Profesional në Menaxhim Biznesi” me profile. Oferta akademike vjen në përgjigje të kërkesave aktuale të tregut të punës dhe ndjek zhvillimin e tij, me synimin që të sinkronizohet me evolucionin dhe t’i paraprijë atij.

Në plotësim të standarteve dhe kriterëve të cilësisë për PS, UMSH ka paraqitur pranë ASCAL një Raport të vlerësimit të brendshëm (RVB) dhe akte rregullatore të institucionit e dokumenta mbështetëse për vlerësimin e PS Master Profesional në Administrim Biznesi (MPAB) (dy-vjecar), me kohë të plotë. Ky PS i nivelit të dytë, është ri-organizuar dhe zhvilluar mbi bazën e programit të mëparshëm (1,5 vjet; 90 ECTS) dhe si i tillë ka përfutuar nga përvoja e mëparshme në aspektin e lëndëve dhe njohurive të ofruara, përshtatshmërisë së tyre në praktikën e biznesit, mundësive për përfshirje në tregun e punës dhe shanseve për fillimin/ zhvillimin e karrierës menaxheriale të të diplomuarve. Ky riorganizimi u bë nëzbatim të LALKSH 80/2015, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e organizimit të UMSH dhe në funksion të nevojave të reja që paraqet tregu i punës, si në sektorin privat ashtu dhe në atë publik.

Në vizionin/qëllimin e PS MPAB 120 ECTS sic del nga takimi i GVJ me drejtues të institucionit përfshihen:

1. Rritja e frymës sipërmarrëse të studentëve në tregun e punës, duke kuptuar me këtë elasticitet në pozicione pune të ndryshme dhe një manaxhim sa më eficient të karrierës personale të të diplomuarit në këtë program.
2. Studenti potencial është i punësuar me disa vite eksperiencë në drejtim në nivelin e ulët që dëshiron të lëviz nga niveli i parë i drejtimin në atë më lart në organizatën ku është.
3. Të lidhen dijet e shumë lloj fushave me synim dije sa më të aplikueshme.

Në pasqyrim të këtij vizioni/qëllimi, moshë mesatare e studentit në këtë lloj PS është rritur me afërsisht 2 vjet duke shkuar në 27 vjec; në kurrikul sipërmarrja është shtuar *en bloc*.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi i studimit (PS) Master Profesional në Administrim Biznesi (MPAB) ofrohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit. Ai ka një <i>strategji të vetën</i> në përputhje me atë të institucionit dhe me zhvillimin ekonomik të vendit. Plani strategjik i zhvillimit të institucionit 2018-23, nga ana e vet, është në mbështetje të prioritetëve strategjike të Shqipërisë.</p> <p>PS MPAB ofrohet pas një studimi tregu që IAL ka bërë për këtë qëllim dhe që konfirmon që sipërmarrjet me përmasë të mesme, në rrugën e konsolidimit dhe të rritjes, përballë konkurrencës që shtohet në segmentet përkatëse të tregut ku ato operojnë, gjejnë nevojën e manaxherëve të nivelit të mesëm. Ky program synon pikërisht atë fashë studentësh që pasi ka një eksperiencë në drejtim dëshiron të zhvillohet profesionalisht për nivele më të larta hierarkie.</p> <p>Tradita shumëvjeçare e shkollimit jo vetëm të të rinjve, që ka filluar prej 1998 dhe është konsoliduar edhe me sistemin e Bolonjës, e karakterizuar nga rikthimi në auditor i cdo të rrituri që punon dhe dëshiron të zhvillojë karrierën personale, gjen pasqyrim në filozofinë dhe mënyrën e organizimit të këtij PS.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Qëllimi kryesor i UMSH i shprehur në strategjinë e zhvillimit të institucionit është: paisja e gjeneratave të reja me dije të nivelit të lartë, me aftësi për t'u përshtatur në tregun e punës, me interesa thelbësore, për të vijuar studimin në vijimësi dhe pa ndërprerje. PS MPAB 120 ECTS është ndërtuar në pasqyrim të këtij qëllimi strategjik.</p>
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Përmbajtja e PS është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Institucioni ofron këtë PS me 120 ECTS, me kohë të plotë, pas rregullimeve të bëra nga Ligji 80/2015 dhe në përputhje me nivelin 7 të Kornizës shqiptare të kualifikimit.</p>
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënies.</p>	<p>Institucioni sapo ka realizuar përmirësimin sasior e në përmbajtje të këtij PS (akoma priten të diplomuarit e parë). Kjo është bërë jo vetëm pas kërkesave të ligjit, por edhe nën një punë krijuese të një ekipi të Fakultetit të Ekonomisë cili ka arsytuar në lidhje me nevojatpër këtë PS dhe mënyrën për ta bërë atë efektiv. Ky proces, bazohet në planin strategjik të institucionit, i cili shprehimisht mban në vëmendje nevojën për përmirësim të PS (Zhvillimi i kurrikulës; Rritja e nivelit të mësimdhënies; Mbështetja e kërkimit shkencor dhe inovacionit; Nxitja e aktiviteteve akademike për studentët; Bashkëpunimi afatgjatë dhe i qëndrueshëm me bizneset) me fokus përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies/nxënies.</p> <p>Të gjithë elementët e përfshirë në Planin strategjik të zhvillimit të institucionit në fokus kanë rezultatet në nxënie të studentit.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Arsytimi në lidhje me hapjen e këtij PS është *well rounded*.
2. PS lidhet natyrshëm me parashikimet për zhvillim të segmentit target të tregut të punës, qëllimet e shpallura të institucionit, dhe rregullimet ligjore sipas Komizës kombëtare të kualifikimeve.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

PS MPAB ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike (FSHE) në UMSH.FSHE ka tre departamente: Departamenti Financë Bankë dhe Kontabilitet, Departamenti i Ekonomisë, Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor. Në secilin prej departamenteve ofrohen programe studimi të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë. Departamenti i Ekonomisë është përgjegjës për PS MPAB. Ai ofron njëkohësisht edhe Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profile: Menaxhim Arsimi; Menaxhim Arti; Menaxhim Shëndeti; Menaxhim i Pasurive të Paluajtshme; Menaxhim Turizmi. Bashkë me Departamentin Financë Bankë Kontabilitet, Departamenti i Ekonomisë bashkëorganizon programin e studimit Bachelor në Shkenca Ekonomike me tre profile: Financë Bankë dhe Kontabilitet, Administrim Biznesi dhe Biznes dhe Ligj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Departamentet kanë në strukturën e punonjësve të tyre pedagogë efektivë dhe me kontratë. Për punonjësit efektivë, tendenca është rritja e kualifikimit të tyre shprehur në grada e tituj. Për pedagogët me kontratë ndiqet politika e angazhimit të personaliteteve akademike dhe specialistëve të njohur në fushat thelbësore të ekonomisë.

Struktura akademike e Fakultetit

Bazuar në të dhënat e RVB (pasqyruar në Anekse, Tabela 1.1 deri 1.7), për strukturën akademike të FSHE gjëjmë që ka rritje të numrit të personelit akademik efektiv (PAE) dhe shtim të proporcionit të PAE me tituj e grada. Në mënyrë të përmbledhur, kjo tregohet nga tabela bashkëngjitur e prodhuar nga GVJ.

Personel në FSHE	Efektiv gjithsej	Efektiv me tituj e grada	Me kontratë
2018-19	40	19 (48%)	24
2017-18	39	14 (36%)	20

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Bazuar në të dhënat e RVB (pasqyruar në Anekse, Tabela 2.1 deri 2.7), për strukturën akademike të DE gjejmë që ka rritje të numrit të personelit akademik efektiv (PAE) dhe dyfishim të proporcionit të PAE me tituj e grada.

Në mënyrë të përmbledhur, kjo tregohet nga tabela bashkëngjitur e prodhuar nga GVJ.

Personel në DE	Efektiv gjithsej	Efektiv me tituj e grada	Me kontratë
2018-19	16	10 (63%)	5
2017-18	13	4 (31%)	5

Personeli i angazhuar në PS MPAB është jo vetëm nga departamenti përgjegjës, por edhe nga departamente të tjera të fakultetit, sipas lëndëve përkatëse në kurrikul.

Punonjësit efektivë me grada e tituj në Departamentin e Ekonomisë jo vetëm bëjnë mësim e kërkim, por edhe bashkërendojnë aktivitetin dhe mbështesin kualifikimin edhe të pjesës tjetër të stafit sic doli nga gjithë takimet me grupet e interesit gjatë vizitave për akreditim të PS.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Në vizitën e vet, GVJ pa kontratat e punonjësve efektivë me anekset, dokumenta të plotësuar të vlerësimit të performancës së punonjësve sipas shkallëve të vlerësimit, dokumenta të plotësuar gjatë rekrutimit, etj. dhe kërkoi shpjegime mbi realizimin konkret në praktikë të mbajtjes dhe freskimit të të dhënave të punonjësve, llogaritjen e nevojave për personel të ri, rekrutimeve, etj.

Të dhënat për nivelin e kualifikimit, kërkimin shkencor të planifikuar, atë faktik të realizuar, etj, konkretizohen në anekset e kontratës së punonjësit me institucionin. Kjo depozitohet në zyrën e burimeve njerëzore të institucionit. Rivlerësimi i anekseve të saj bëhet një herë në vit në vjeshtë, pas mbylljes së vitit akademik. Drejtuesit e njësive bazë dhe asaj kryesore janë aktorë të rëndësishëm në vlerësimin e performancës vjetore të cdo punonjësi efektiv, në përcaktimin e nevojave për personel të ri dhe janë pjesëmarrës në rekrutim.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Për përmbushjen e misionit të vet, specifikisht edhe të kërkesave të PS MPAB, institucioni është organizuar në njësi kryesore e njësi bazë që funksionojnë me rregullore përkatëse dhe personel akademik e ndihmës.</p> <p>Institucioni ka 3 fakultete, ku ai i Shkencave ekonomike, që mbulon këtë PS ka 3 departamente.</p> <p>Secili departament ka personel më vete, përgjegjës, ps për të cilat mban përgjegjësi, rregullore, etj.</p> <p>Departamenti përgjegjës për PS MPAB është Departamenti i Ekonomisë. Ky përbëhet nga 16 anëtarë efektivë, nga të cilët 8 pedagogë kanë gradën shkencore "Dr"/PhD, 2 pedagogë kanë edhe titullin Prof. Asoc.</p> <p>PS MPAB mbulohet në mësimdhënie edhe nga personel akademik i departamenteve të tjera të fakultetit. Nga kjo, numri pedagogëve me grada e tituj që japin mësim/bëjnë kërkim në funksion të këtij PS, ngrihet.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të</p>	<p>Njësia bazë, me mbështetje të njësive kryesore dhe zyrave të tjera të institucionit, drejton dhe koordinon punën për realizimin me sukses të detyrave që duhen kryer në këtë PS, si në mësimdhënie, në praktika profesionale, këshillim, organizim provimesh, garantim të cilësisë së</p>

<p>personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>procese, etj. Në gjithë takimet me të gjitha grupet e interesit, referimi kryesor ishte tek Departamenti i Ekonomisë dhe përgjegjësjë e tij. Ndërtimi i punës duke fokusuar peshën kryesore të përgjegjësjë tek Departamenti, është në përputhje me kuptimin aktual të organizimit që del nga LALKSH 80/2015.</p> <p>Njësia bazë është e përfshirë drejtpërdrejt në vlerësimin e performancës së personelit akademik dhe në rekrutim. Kjo realizohet me procedura të përcaktuara në rregulloret përkatëse dhe program pune. Departamenti këtë detyrë e kryen në bashkëpunim me zyrën e BNJ dhe drejtuesit e njësisë kryesore. Drejtuesi i departamentit/përgjegjësi i grup lëndëve është anëtar i komisionit të vlerësimit të performancës së punonjësit mësimor-shkencor dhe anëtar i komisionit të rekrutimit të punonjësjë të rinj.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni është organizuar për të përmbushur misionin e tij, sipas kushteve të parapara në legjislacion. 2. Ndërgjegjja e njësisë bazë në lidhje me detyrat/detyrimet për zbatimin e PS shfaqet në cdo element, si në dokumenta të shkruara, edhe në takimin me grupet e interesit. Departamenti është pika fokale që tërheq fjetet e punës për këtë PS. Organe/zyra të tjera brenda institucionit bashkërendojnë punën me Departamentin për realizimin e të gjithë elementeve të nevojshëm për PS MPAB. 	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Departamenti i Ekonomisë ka në përberjen e tij pedagogë efektivë të angazhuar prej shumë vjetësh që garantojnë qëndrueshmërinë e tij dhe të rinj me grada të fituara në vënd ose jashtë. Në PS MPAB 120 ECTS aktivizohen PA nga Departamenti i ekonomisë dhe nga departamente të tjera të fakultetit. Të gjithë kanë gradën shkencore Dr/PhD dhe disa edhe tituj. Vetëm një person ka nivelin e kualifikimit MSc. Të gjithë angazhohen në mësimdhënie dhe aktivitete të tjera për zhvillimin e kurrikulës dhe të vetes. Institucioni ka bërë një punë rregulluese për proceset që nga rekrutimi e deri në vlerësimin vjetor të performancës duke lidhur cdo proces me procedura, dokumenta tip, persona përgjegjës me qëllim njohjen e kontributeve dhe respektimin e të drejtave të palëve. Personel ndihmës akademik funksionon në dispozicion të këtij PS, në kuadrin e organizimit të brendshëm.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Nga studimi i tabelave të ofruara në RVB (dhe të vendosura në Aneks të RVJ, Tabelat 4 dhe 5) vihet re që për të realizuar PS MPAB me 120 ECTS janë angazhuar në 6 vitet akademike 2013-2019 personel akademik, përbërja e të cilit në mënyrë të përmbledhur mund të pasqyrohet si më poshtë:

- Për vitin akademik 2018-2019: Gjithsej janë angazhuar 11 PAE (90% me tituj/grada) dhe 2 PAK. (100% me tituj/grada)

- Për vitin akademik 2017-2018: Gjithsej janë angazhuar 11 PAE (100% me tituj/grada) dhe 1 PAK. (100% me tituj/grada)
- Për vitin akademik 2016-2017: Gjithsej janë angazhuar 9 PAE (89% me tituj/grada) dhe 1 PAK. (100% me tituj/grada)
- Për vitin akademik 2015-2016: Gjithsej janë angazhuar 8 PAE (88% me tituj/grada) dhe 2 PAK. (100% me tituj/grada)
- Për vitin akademik 2014-2015: Gjithsej janë angazhuar 8 PAE (75% me tituj/grada) dhe 4 PAK. (100% me tituj/grada)
- Për vitin akademik 2013-2014: Gjithsej janë angazhuar 6 PAE (17% me tituj/grada) dhe 7 PAK. (100% me tituj/grada)

Programi mbahet kryesisht me PAE me grada e tituj. Këta janë hartues të syllabuseve, dhënës në auditor, mbikqyrës të praktikave, etj. Të dhëna mbi raportet sipas kualifikimit bazuar në RVB gjenden në Aneks (Tabelat 4 dhe 5).

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe koordinorët (i vendosur në RVJ në Aneks, Tabela 3.1-3.6).

Këshilli Shkencor i Programit përbëhet nga 3 persona, personel akademik me grada e tituj shkencorë. Nga këta, të paktën njëri është direkt i përfshirë në mesimdhënie në këtë PS sipas tabelave 1; 2; dhe 4 në Aneks.

Komisioni i përhershëm i FSHE që i shërben PS MPAB 120 ECTS, i krijuar në vitin akademik 2017-18 sipas normave të Ligjit 80/2015 përbëhet nga 7 anëtarë, njëri student dhe gjithë të tjerët të kategorisë Profesor, ku afërsisht gjysma janë mesimdhënës në këtë PS (Tabela 3.6, në Aneks).

- Të dhëna sipas gjinisë (Tabela 6 ne Aneks)

Bazuar në të dhënat ofruara nga GVB (Tabela 6, në aneks), personeli akademik i përfshirë në mesimdhënie në PS MPAB (120 ECTS) ka përbërje gjinore përpjestimore për të dyja gjinitë.

- Të dhëna sipas moshës (Tabela 7 ne Aneks)

Të dhëna sipas moshës së personelit gjenden në tabelën 7. Sic kuptohet nga tabela, mesimdhënësit në PS MPAB (120 ECTS) kanë grada e tituj duke filluar nga moshë 56 e sipër. Dy PAE në grupmosha më të reja janë doktoruar jashtë vendit dhe si të tillë ata shpejt mund të kualifikohen për titullin Prof As sipas legjislacionit në fuqi. Nga pikpamja numerike e PAE gjërat shkojnë mirë për 10 vitetë ardhshme në këtë PS (duke konsideruar si pikë të mesit për intervalin e moshës 56-65 vitin 60 të jetës dhe duke pasur parasysh moshën e daljes në pension dhe faktin që pedagogët me Drme eksperiencë po punojnë për ngritjen e nivelit të kualifikimit të tyre dhe marrjen e titullit Prof As (sic doli nga verifikimi i dosjeve të personelit të Departamentit).

- Kontratat e punës

Kontratat e punës janë individuale, të lidhura mes punëmarrësit dhe punëdhënësit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe Statutin dhe Rregulloren e UMSH. Ato janë të pajisura me anekse të cilat rinovohen cdo vit, për cdo punonjës akademik efektiv (edhe për ata me kontratë pa afat). Interes paraqet Aneksi A i kontratës ku konkretizohet kontributi i punonjësit në 5 elementë kryesorë: mesim, aktivitete jashtë auditorit në ndihmë të procesit mësimor, kërkim shkencor, kontribut institucional, transferim teknologjie dhe zhvillim profesional. Kjo mënyrë e përcaktimit të objektivave personale vjetore shoqëruar edhe me efekte financiare të lidhura me koeficientë vlerësimi për cdo lloj kontributi të paranjohur në kontratë/aneks është një mënyrë shkencërisht e bazuar për të shkaktuar motivim tek punonjësi.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Në RVB thuhet: Fakulteti ka në përbërjen e tij 64 anëtarë të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personel administrativ që është në shërbim të punës kërkimore dhe shkencore të të gjithë programeve. Duke llogaritur që PAE janë 40 veta, dhe PAK janë 24 veta, nuk mund të themi sa është numri i personelit ndihmës administrativ që kryen shërbime në Sekretarinë mësimore (4+1), zyra e garantimit të cilësisë (3), biblioteka (2), zyra e burimeve njerëzore (2), etj në garantim të mbarëvajtjes së këtij PS (Numrat në kllapa janë persona që u takuan në këto funksione gjatë vizitës së GVJ).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Databaza e rekrutimeve FSHE 2018; Vlerësim i një pedagogu të brendshëm; Vlerësim i një pedagogu të jashtëm; Dy dosje të PA; Dokument të plotësuar sipas një formati të paracaktuar për mbajtjen e shënimeve për kontrollin e mësimin të një PA nga Departamenti; F14 Vlerësimi nga personi pranë institucionit, F15 Vlerësimi nga pedagogu mbikqyrës, F16 Vetvlerësimi i studentit për praktikën, F17 Raportimi i studentit për përfundimin e praktikës, F18 Dokument që e plotëson Departamenti për shpërndarjen e studentëve, F22 Format i aplikimit të studentit për praktikë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre; Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Personeli akademik është angazhuar në mësimdhënie, në drejtim të studentëve në praktikat mësimore, në këshillim të studentëve, në tutoriat, në përmirësimin e vazhdueshëm të syllabuseve, në aktivitete të tjera në mbështetje të PS. Personeli administrativ respektivisht është angazhuar në detyrat koordinuese, të bibliotekës, sekretarisë mësimore, burimeve njerëzore, etj. Personeli akademik dhe ai administrativ janë angazhuar në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. Secili më vete dhe në bashkëpunim, të organizuar nëpër njësitë përkatëse të institucionit synojnë realizimin e mësimin, dhënien e dijeve të qëndrueshme dhe kërkim shkencor.
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve; Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Vendimmarrja kolegjiale në nivel njësie është baza e ndryshimeve në kurrikul. Pastrimi i kurrikulës nga përsëritjet e panevojshme realizohet në mënyrë kolegjiale. Edhe futja e kurrikulës së këtij PS me 120 ECTS vjen pas një arsytimi racional dhe të bazuar në disa lloje këndvështrimesh që personeli akademik me përvojë ka bërë përpara futjes në zbatim. Ky angazhim shfaqet në takimet me drejtues të njësisë si dhe me pedagogët e takuar nga GVJ. Rishikimi i ngarkesës së personelit akademik si pjesë e vlerësimit të performancës që bëhet në cdo vjeshtë, shoqëruar me caktimin e objektivave vjetore për vitin pasardhës në disa aspekte të punës së cdo individi, shërben vec të tjerash edhe për përcaktimin e nevojave të ardhshme për personel akademik mësimor shkencor. Bazuar në këto nevoja, duke shfrytëzuar edhe një pool të dhënash nga rekrutime të shkuara, realizohen proceset e marrjes në punë të personelit të ri sipas kriterëve të legjislacionit në fuqi. Personat e

	<p>marrë rishtazi trainohen për metodologji dhe pasi kalojnë pjesën e shoqërizimit, marrin ngarkesë duke kaluar në një proces caktimi objektivash/ngarkesa pune sipas interesave të kualifikimit personal.</p> <p>Gjithë ky shpjegim del si kuptim i GVJ nga takimi me grupe të ndryshme gjatë vizitës në institucion dhe parja e dokumentave rregulluese e atyre operative.</p>
--	--

Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

- Kriteri 1** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;
- Kriteri 2** Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;
- Kriteri 3** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;
- Kriteri 4** Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.

Procedura e rekrutimit të personelit përcaktohet në Statutin dhe Rregulloren organizative të institucionit. Duke u nisur nga nevojat e identifikuar në Departament, bëhet kërkesë për personel të ri akademik, tek dekani, i cili e përcjell këtë në Rektorat. Bazuar në kërkesat e ardhura, institucioni planifikon, shpall dhe organizon procedurën e rekrutimit duke marrë masa për konkurrin të hapur dhe transparencë.

Sic u tha edhe më sipër, në vitin 2018-19 në *Departamenti* i Ekonomisë që është përgjegjës për PS MPAB 120 ECTS ka 16 (76%) PAE dhe 5 PAK. Mund të thuhet që PAE kapërcen kufirin e parashikuar nga standarti.

Për periudhën 2017-19 që është zhvilluar mësimi në këtë PS, 14 (88%) nga PA mësimdhënës i angazhuar në *Programka* qënë efektiv dhe vetëm 2 PA me kontratë.

Nga verifikimi i të dhënave edhe me tabelat për PS MPAB 90 ECTS, duket që institucioni ka patur në vëmendje plotësimin e kriterëve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të këtij treguesi.

Vlerësimi i personelit bëhet mbi procedura të përcaktuara dhe të shpallura. Ai ndjek hapat normale që literaturat e fushës së BNJ rekomandojnë. Vlerësimi bëhet me disa nivele dhe nga disa drejtime. Procesi i vlerësimit bëhet mbi bazë formatesh të paracaktuara në institucion, me vetëraportim nga ana e punonjësit mësimor-shkencor dhe me konfirmim me shkrim nga drejtuesi i departamentit ose grup lëndëve. Fillon nga poshtë lart, duke kombinuar vetvlerësimin me vlerësimet nga studentët (në përfundim të cdo lënde me format të përcaktuar), vlerësimet nga kontrolli i planifikuar i mësimin (me format të përcaktuar), etj.

Të dhënat që dalin nga procesi i vlerësimit, shërbejnë për caktimin e objektivave të reja për vitin pasardhës dhe treguesve konkretë në 5 elementë kryesorë: mësim, aktivitete jashtë auditorit në ndihmë të procesit mësimor, kërkim shkencor, kontribut institucional, transferim teknologjie dhe zhvillim profesional. Të gjitha konkretizohen në Aneksin A të kontratës së punës pas një vendimi që merr një komision i përbërë nga Zv rektori i burimeve njerëzore, Dekani/përgjegjësi i departamentit ose i grup lëndëve në arsyetim të përbashkët me vetë punonjësin. Ky proces mbyllet me nënshkrimin e kontratës deri në dt 10.10 të cdo viti dhe ka efekte dhe financiare në shpërndarjen e fondeve për mbështetjen e kualifikimit shkencor të cdo punonjësi.

Nga RVB lexohet “Bazuar në aktet rregullative të UMSH, që nga

	<p>fillimi i aktivitetit të tij, institucioni disponon një bazë të dhënash përsa i përket njoftimeve të vendeve vakante, kritereve dhe raporteve/ procedurave të rekrutimit të personelit. Kjo baze të dhënash administrohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore”.</p> <p>GVJ ju vu në dispozicion një bazë të dhënash për persona që kanë konkuruarnë FSHE në vitin 2018.</p>
--	--

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i programit ka gradën shkencore DR të marrë në UNITIR. Në CV e ofruar nga institucioni shikohet një përvojë e pasur në manaxhim në praktikë, përvojë e gjatë në mësimdhënie dhe aktivitetet kërkimor shkencor në funksion të kualifikimit personal nga ana e Përgjegjësit të PS.</p> <p>N/A</p> <p>Të gjithë mësimdhënësit në PS MSHAB 120 ECTS janë DR e lart. Vetëm një PAE është me MSc.</p> <p>Titullarët e institucionit, Të fakultetit, të departamentit dhe të PS janë të punësuar me kohë të plotë në UMSH.</p> <p>Për organizimin e praktikave profesionale institucioni ka përcaktuar procedura dhe persona përgjegjës për kryerjen e tyre.</p> <p>Dokumenta format me emër F14, F15, F16, F17, F18, F22 si dhe letra e rektorit drejtuar institucionit janë pjesë e rregulimeve të proceseve të praktikës.</p> <p>Aktualisht duke konsideruar numrat dhe shpërndarjen në kalendarin akademik, personeli në FSHE është i mjaftueshëm për mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>
---	--

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Rregullorja e këtij PS parashikon që studimet mund të mbyllen me një punim diplome apo provim. Në rregulloren e PS nuk ka të përcaktuar një notë fikse që ndan një kategoritë e studentëve të përshtatshëm për diplomë, por në takim me përgjegjësin e Departamentit u tha që ndarja bëhet tek nota mesatare 8. Në vitin akad 2018-19, që është i pari kur mbyllen studimet e të regjistruarve të parë në PS MPAB me 120 ECTS, të gjithë studentët do të bëjnë një provim në dalje. Ky provim i konceptuar si një përgjigje për disa pyetje teorike dhe disa raste të vogla studimi, ka 18 ECTS dhe përfshin tema të rëndësishme të disa lëndëve (afërsisht 5) të zhvilluara në dy vitet. Një program temash që do përfshihen në provim është përgatitur nga Departamenti dhe në kohën e takimeve të akreditimit, ishte në proces shpërndarjeje. Studentët e vitit II që ishin në takim me GVJ do të shkonin ta merrnin bashkë me sqarimet përkatëse tek përgjegjësi i Departamentit.</p> <p>Një kurs studentësh ka afërsisht 50 veta. PS MPAB 120 ECTS angazhon aktualisht 15 pedagogë me gradën Dr e lart. Kuptohet që PS ka mjaftueshëm PA për të respektuar normat e Standartit II. 5.</p>
---	---

	Kriteri 3.
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	Aktualisht nuk aplikohen Kriteri 1 dhe 2. Por, duke shikuar CV dhe autorësinë e syllabuseve në PS MPAB 120 ECTS mund të themi që kapacitetet janë për të plotësuar këto dy kritere.
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Personeli ndihmës mësimor shkencor i organizuar për të shërbyer PS MPAB 120 ECTS gjendet në këtë institucion në njësi/detyra të tilla si: biblioteka, sekretaria mësimore (e cila shërben edhe pasditeve në oraret kur zhvillon mësimin ky master), koordinatori, tutorët, sanitarët, etj. Mënyra e organizimit të tyre në hapsirë dhe kohë duket në funksion të realizimit të orëve të studimit në auditor dhe jashtë tij.</p> <p>Burimet njerëzore të angazhuara në PS MPAB 120 ECTS janë njëkohësisht të angazhuara në programe të tjera respektive. Disa nga mësimdhënësit në këtë PS janë njëkohësisht anëtarë të departamenteve të tjera të fakultetit. Disa nga mësimdhënësit kryejnë njëkohësisht detyra ndihmëse jashtë auditorit në role të tutoriatit, koordinimit, etj Mënyra se si është organizuar shërbimi për të kryer të gjitha llojet e detyrave të nevojshme për t'i shërbyer njëkohësisht edhe këtij PS lë të nënkuptohet që institucioni punon për optimizim të përdorimit të BNJ.</p>
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Rregullimet ligjore mbi ngarkesën gjenë pasqyrim në Rregulloren Organizative të UMSH, Rregulloren e FSHE, planet mësimore dhe anekset e kontratës individuale të punës.</p> <p>Ngarkesa mësimore e personelit akademik të angazhuar në këtë PS brenda auditorit si dhe në 4 elemente të tjera aktiviteti gjendet e specifikuar në anekset e kontratës individuale të punës, është e përkthyer në orë nëpërmjet koeficientëve ashtu sic e kërkojnë praktikatat më të mira të vlerësimit të performancës individuale.</p>
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Të dhënat personale të cdo PA të plotësuar dhe <i>up to date</i> ndodhen në zyrën e BNJ. Disa të dhën operative që i takojnë proceseve në zhvillim (vlerësim mësimi, etj) ndodhen në Departament, të tjera në Zyrën e garantimit të cilësisë.</p> <p>Lista e plotë e PA të angazhuar në këtë PS është e përfshirë në RVB. Kjo listë është edhe në Departament. Listë të plotë të personelit administrativ.</p> <p>Kriteret për përzgjedhje të personelit në rekrutim shpallen publikisht në faqen e UMSH dhe në mjete të medias publike sipas rastit</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ka vënë në dispozicion të PS MPAB 120 ECTS personel akademik në përshtatje me kriteret ligjore. Ky rekrutohet me procedura transparente, përdoret në mënyrë optimale dhe angazhohet në procese jo vetëm ngushtësisht të mësimdhënies. Aktiviteti i të gjithë punonjësve është i rregulluar me norma/kritere të matshme për kontributin e secilit dhe njihet nga institucioni.
2. Personeli ndihmës mësimor shkencor dhe ai administrativ janë në dispozicion të nevojave të këtij PS.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Piesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Mbështetur në të dhënat e RVB, si dhe në vizitën në UMSH konstatojmë që Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” ushtron aktivitetin e tij akademik dhe mësimor në një sipërfaqe totale prej 3860 m², i cili është i pozicionur brenda qytetit. Godina është e pajisur me mjete ndriçimi alternative, internet WIFI 24 orë, projektorë, sistem mbrojtjeje nga zjarri, CCTV, ashensorë, etj.

Institucioni disponon 6 amfiteatro dhe 15 salla seminaresh. Këto ambiente përdoren për të gjithë studentet e këtij universiteti. Në të shumtën e rasteve studentët e programit Master Profesional në Administrim Biznes përdorin amfiteatrot, të cilët kanë kapacitete prej 100-120 vendesh. Institucioni disponon gjithashtu laboratorët e teknologjisë informative dhe gjuhëve të huaja, të cilat janë të pajisura me sistem audio, kompjutera, etj. Megjithëse cdo staf akademik ka tavolinën dhe kompjuterin personal, nga vizita në këto ambiente u vu re që hapsira e këtyre ambienteve është e vogël në krahasim me numrin e stafit akademik. E njëjta situatë u vu re dhe në ambientet e zyrave të stafit administrativ. Psh, zyra e pranimit dhe e sekretarise, e cila duhet të jetë në shërbim të studentëve dhe stafit akademik, paraqet një hapësirë shumë të limituar ku qëndrojnë 5 personel administrativ dhe ku ka vizitorë të shumtë.

Biblioteka e këtij institucioni është e vendosur në katin -1 të godinës dhe ka një sipërfaqe prej 107 m². Kjo bibliotekë përmban rreth 4200 libra fizike, të cilat i përkasin të tre fakulteteve së bashku. Institucioni ka siguruar një bibliotekë online që përmban një sasi të konsiderueshme titujsh të cilat shërbejnë për studentët por edhe për stafin akademik në ndihmë të kërkimit shkencor.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset për Programin e studimit (Tabelat 8 në Aneks)

Gjatë vizitës në ambientet e universitetit, grupi i vlerësimit pati mundësinë të evidentonte të gjithë ambientet që disponon institucioni. Detajet në lidhje me sallat e leksioneve, seminareve, etj. gjenden bashkangjitur në tabelën 8.

- Mjediset për stafin:

Grupi i vlerësimit vizitoi gjithashtu dhe disa zyra administrative, si zyra e regjistrimit, zyra e informacionit, zyra e përgjegjës të departamentit si dhe sallat e stafit akademi. Sipas vëzhgimeve, ambientet e stafit ishin të hapësirave të vogla. Shpesh kjo situatë përkthehet në dyndje në këto ambiente dhe limitime në sqarimin e problematikave të ndyshme (si psh, në zyrën e studentit).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>stitucioni është i vendosur në një godinë me qera ku zhvillon të gjithë procesin mesimor si dhe aktivitetet e tjera akademike dhe administrative;</p> <p>Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 10 vjet;</p> <p>Ky programi i studimit ofrohet në një godinë të vetme;</p> <p>UMSH garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e masterit profesional në Administrim Biznes. Gjithashtu, për realizimin e këtyre praktikave, institucioni përdor dhe ambientet e institucioneve/kompanive/organizatave të tjera ku studentët kryejnë praktikat.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Megjithëse biblioteka e institucionit përmban tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse, kjo literaturë duket jo e mjaftueshme për disa lëndë specifike të programit. Kjo konfirmohet dhe nga takimi me studentët dhe kërkesa e tyre për të patur libra të integruar specifikisht me programin e studimit;</p> <p>Në bibliotekë egziston literaturë bazë për realizimin e detyrave të kursit dhe përgatitjen e tezës përfundimtare. Ndihmëse të vecantë në realizimin e tyre padyshim është dhe biblioteka elektronike;</p> <p>UMSH garanton një shumë të konsiderueshme të botimeve elektronike, mbi treqind mijë tituj nga të cilat 2413 tituj i përkasin fushës së shkencave ekonomike, abonim në Questia si dhe në revistën prestigjioze “The Economist”. Të gjitha këto resurse vijnë në ndihmë të realizimit me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Institucioni mbështet kërkesën për shtimin e zërave të bibliotekës. Në lidhje me shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike në Nëntor 2018 propozon një listë prej 11 titujsh të librave bazë (te cilat janë për të gjitha programe bachelor dhe master të këtij fakulteti);</p> <p>Orare të shërbimit të bibliotekës janë të shpallur në hyrje të bibliotekës. Biblioteka qëndron e hapur gjatë javës 08.00-17.00 dhe të shtunën paradite.</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje</p>	<p>Numri i klasave dhe mjediseve të tjera me pajisje elektronike</p>

<p>elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>dhe të teknologjisë së informacionit janë në përshtatshmeri me numrin e studentëve në këtë program studimi. Kjo u deklarua nga raporti i vetëvlerësimit si dhe u konfirmua nga vëzhgimi i ambienteve nga grupi i vlerësimit të jashtëm;</p> <p>Institucioni disponon laboratore të pajisur me sasi të mjaftueshme PC, klasa me vidioprojektore, printera dhe fotokopje që ju vijnë në ndihmë studentëve. Sallat e leksioneve janë të ndërtuara në formë amfiteatri dhe të pajisura me sistem autoviziv komunikimi;</p> <p>Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Ky program studimi nuk kërkon aparatura të vecanta megjithatë laboratorët përmbajnë kompjutera të mjaftueshëm, të cilët janë të pajisur me programet bazë të nevojshme;</p> <p>Institucioni ka vënë në dispozicion të programit të studimit 2 laboratore me PC të cilat janë mëse të mjaftueshëm për programet e studimit në shqyrtim.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

- Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të masterit profesional në Administrim Biznes. Ky institucion kanjëvendndodhje afatgjate dhe garanton ambiente dhe mjedise të përshtatshme për mesimdhënie dhe realizimin e aktiviteteve të tjera si praktikat profesionale, etj.
- Institucioni është i pajisur me një bibliotekë relativisht të vogël. Në ndihmesë të librave që gjenden aty, institucioni ka siguruar abonimin në revista online si dhe në një database të rëndësishme si "Questia". Studentët bashkë me stafin akademik kanë mundësi të përdorin këto resurse për punimet e tezave ose kërkimeve shkencore. Institucioni vë gjithashtu në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore, sic janë laboratorët, vidioprojektoret, kompjuterat, fotokopjet, etj.
- Sallat dhe zyrat e stafit akademik dhe administrativ janë relativisht të vogla në krahasim me numrin e tyre.

Rekomandime:

Nga sa u konstatua mësipër, grupi i vlerësimit sugjeron që të rritet larmishmëria e librave në bibliotekë, të cilat duhet të përfshijnë jo vetëm disa libra bazë të lëndëve por dhe librat mbështetës që gjenden në syllabuset e secilës lëndë. Duke qënë se biblioteka është në katin -1, ky ambient nuk është i pajisur me dritare, gjë e cila është pengesë për një tërheqje sa më të lartë të studentëve në sallën e leximit. Oraret e bibliotekës janë të mjaftueshme. Sugjerohet që orari i bibliotekës të shpallet edhe në web-in e institucionit.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është pjesë e OJF "Qendra Mesdheu" e cila është e regjistruar si person juridik pranë Gjykatës së Rethit Gjygesor Tiranë me objekt veprimi ofrimin e shërbimeve në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Bordi i "Qendrës Mesdheu" emëron Bordin e Administimit që ka detyrë mbarvajtjen financiare dhe i përgjigjet Qendrës për këtë. Organi më i lartë vendimmarrës në lidhje me

mbarvajtjen financiare është po ky bord. RVB jep të dhëna vetem për vitet akademike 2017-2018 dhe disa të dhëna të parashikuara për vitin në vijim, 2018-2019. Sipas të dhënave të paraqitura në RVB, (Tabela 9, në aneks), 97.8% e burimeve financiare të universitetit vijnë nga tarifat shkollore. Vetem 1.8% të këtyre burimeve janë të lidhura me grantet për kërkim shkencor/kontrata/projekte dhe pjesa tjetër, 0.4% i përkasin kategorisë “te ardhura të tjera nga aktivitete tregtare”. Kostoja për student është 113.186 leke për vitin akademik 2017-2018. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i mendimit se bazimi i burimeve financiare në pothuaj tërësisht në tarifat studentore e bën universitetin shumë të ndjeshëm ndaj regjistrimeve vjetore të studentëve. Kjo bën që parashikimet e investimeve si dhe strategjitë afatgjata të jenë të varura nga ky tregues.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në vitin akademik 2017-2018 për “Universitetin Mesdhetar i Shqipërisë” (në përqindje):

- Grantet për kërkim – **1.8%**
- Konsulencat, shërbimet – **nuk ka**
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit – **97.8%**
- Sponsorizimet – **nuk ka**
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) – **nuk ka**
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj – **nuk ka**
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) – **0.4%**

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (tabela 9.1)(në përqindje)

Megjithëse grupi i ekspertëve kërkoi të dhëna të plota për 6 vitet e fundit, institucioni ofroi vetëm të dhëna në lidhje me dy vitet e fundit (pra ato që janë dhe në RVB). Nga të dhenat e Tabelës 9.1, totali i financimit për vitin akademik 2017-2018 arrin në 270.219 mijë leke (78.3% e shumës totale e të ardhurave).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, ekspertët e vlerësimit kërkuan pjesën përmbledhëse të raportit të auditit. Dokumenti që na u ofrua ishte i përgjithshëm dhe nuk përmbante shumë detaje. Megjithatë, nga çfarë është deklaruar në RVB, 97.8% e të ardhurave financiare i përkasin tarifave studentore.</p> <p>RVB deklaroi se vetëm 1.8% e të ardhurave financiare vijnë nga grantet për kërkim shkencor dhe projekte, shumë e cila është minimaliste nëse konsiderojmë që ky program është një program masteri profesional, 2 vjeçar dhe që ka mision dhe prespektiva si “mbështetja e kërkimit shkencor dhe inovacionit, nxitja e aktiviteteve akademike për studentët”, ref. Stand. I.11, Kriteri 1 (RVB).</p> <p>Raporti i vetëvlerësimit të brendshëm deklaroi se opinioni i auditit të jashtëm ka qenë pozitiv vit pas viti, megjithatë nuk kemi një evidencë konkrete për të vërtetuar nëse institucioni analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në</p>

	funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Administratori i institucionit çdo vit harton një raport të detajuar projektbuxheti të propozuar nga njësitë kryesore dhe ato bazë. Ky raport I vihet në shqyrtim Bordit Administrativ të “Qendrës Mesdheu”;</p> <p>RVB dëshmon se institucioni ka një qëndrueshmëri financiare dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p> <p>Duke marrë parasysh dhe numrin e studentëve të rregjistruar, 57 studentë për vitin akademik 2017-2018, dhe 56 studentë për vitin akademik 2018-2019, mund të thuhet se ky numer është relativisht i kënaqshëm.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<ul style="list-style-type: none"> - Duke u bazuar në kërkesat ligjore dhe detyrimet e rregullores institucionale, institucioni ndermerr një auditim të jashtëm i cili ka për detyrë të identifikojë burimet e të ardhurave, shpenzimeve dhe kostove për student. - Bordi i Administrimit merr në shqyrtim raportin e auditit të jashtëm, po jo vetëm, dhe harton strategjitë afatmesme të këtij institucioni. Ky program studimi siguron një numër të konsideruar studentësh për cdo vit akademik, gjë e cila mbështet të ardhurat financiare. - Grupi i vlerësimit të jashtëm sugjeron diversifikimin e të ardhurave të burimeve financiare. 	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

UMSH ka në stukturën e saj Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, e cila është e ngarkuar me detyrën e ndjekjes së cilësisë së brendshëm në nivel programi, departamenti dhe insitucioni. Kjo njësi në bashkëpunim me departamentet dhe fakultetet realizon kontrollet rutinë dhe vë në dijeni nivelet drejtuese respektive për rezultatet e gjetura. Më tej, janë departamenti dhe fakulteti në bashkëpunim me rektoratin vendimmarrëse për adresimin e problematikave si dhe zgjidhjeve të tyre.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave kryen dy herë në vit anketime me studentët e programit të masterit profesional në Administrim Biznes. Këto anketime i përkasin çdo lënde për çdo semestër.
 - Anketimi bëhet përpara sezonit final dhe numri i studentëve të anketuar është relativisht i lartë (jo me pak se 60% e studentëve të rregjistruar për çdo program studimi).
 - Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave bën të mundur përpunimin e rezultateve të anketave të studentëve. Nga sa u konstatua dhe nga dosjet, kjo njësi nxjerr rezultatet të cilat përfshihen në dosjen e lektorit.

- Rezultatet në përgjithësi janë të kenaqshme. Aty ky identifikohen probleme, nivelet drejtuese shkruajnë rekomandimet e tyre dhe sugjerohen për përmirësim në vitin pasardhës.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Duke konstatuar të dhenat në raportin e vlerësimit të brendshëm, (Tabela 10), vihet re një ndryshim i shpeshtë i anëtarëve të NJSBCZHK. Anëtarët më të vjetër janë të vitit 2017-2018 dhe më të rinjtë 2018-2019. Duke qenë se kjo njësi është e një rëndësie të veçantë sugjerohet një stabilitet në anëtarët e saj e cila do të sjellë një angazhim më të përkushtuar dhe zhvillim të politikave të qëndrueshme të sigurimit të cilësisë në nivel institucioni.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

NJSBCZHK është e angazhuar më së miri në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti. Sugjerim tjetër që vjen nga grupi i vlerësimit të jashtëm është suporti teknologjik që mund ti vijë në ndihmë kësaj njësie.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

NJSBCZHK në bashkëpunim me departamentet ka hartuar formularë të vetëvlerësimit të stafit akademik. Ky formular nxjerr në pah pikat e forta si dhe nevojat për përmirësim shumë indikatorë si: përgjegjësitë e stafit, angazhimi i tij, plotësimi i kërkesave dhe punës së kërkuar, marrdhëniet mes kolegësh si dhe me studentët, aftësitë për përdorimin e pajisjeve të nevojshme, aftësi të tjera të nevojshme në vendin e punës, korrektësia, bashkëpunimi, etj. Vetëvlerësimi bëhet nga vetë stafi dhe aprovohet nga dekani dhe zyra e burimeve njerëzore.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Vetëvlerësimi i lartpërmendur bëhet një herë në vit dhe futet në dosjen e secilit staf. Gjithashtu kësaj dosje i bashkangjitet edhe vlerësimi për arritjen e katër objektivave: 1- Kontributi në mësimdhënie bashkëkohore në përputhje me standartet institucionale; 2- Kontributi personal dhe institucional në kërkimin shkencor; 3- Kontribut institucional; 4- Kontribut profesional.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Institucioni paraqiti dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit e studentëve si dhe rezultatet e disa lëndëve të përzgjedhura në mënyre rastësore;
2. Formularin e vlerësimit të performancës dhe zhvillimit profesional të punonjësve;
3. Planin e zbatimit për katër objektivat: a- Kontributi në mësimdhënie bashkëkohore në përputhje me standartet institucionale; b- Kontributi personal dhe institucional në kërkimin shkencor; c- Kontribut institucional; d- Kontribut profesional.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Me anë të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK), institucioni ka ndërtuar metodologji të detajuar vlerësimi, duke përdorur instrumenta matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit të masterit profesional në Administrim Biznes;
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;	
Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	Ky institucion merr parasysh vlerësimet semestrale dhe vjetore të

<p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>elementëve të ndryshëm të cilësise dhe i përfshin ato në vlerësimin e lëndëve/programit/petagogëve/etj. Mënyrat e ndryshme të vlerësimit bëjnë që institucioni dhe programi i studimit të arrijë objektivat e cilësisë dhe të këtë përparime të mëtejshme në cilësinë e brendshme;</p> <p>NJSBCZHK bën me dije të gjithë instancat për mënyrat e vlerësimit, merret me proceset e vlerësimit dhe shpërndan rezultatet e përfuara në nivelet drejtuese si rektorati dhe fakulteti. Çdo staf akademik njoftohet për rezultatet e tij në fund të vitit akademik. Këto rezultate reflektojnë edhe në vlerë të shtuar monetare për vitin pasardhës;</p> <p>Institucioni përdor disa mënyra vlerësimi të cilat janë konstatuar dhe nga dokumentacioni shtesë I grupit të vetëvlerësimit dhe nga takimet me stafin akademik dhe studentët. Këto metoda janë të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe të vlerësimit të lektorit, mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Sondazhe të studentëve për cdo program studimi; Pyetje konceptuale; Intervista; <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Dëgjime në auditor; Vlerësimi me pikë; Vlerësimi i detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës;
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Stafi i përfshirë në programin e masterit profesional “Administrim Biznes” kishte informacion të qartë në lidhje me procesin e vlerësimit të brendshëm. Në fund të çdo viti akademik ata njoftoheshin për rezultatet e tyre;</p> <p>Faqja zyrtare e institucionit nuk përmban informacione në lidhje me vlerësimin e brendshëm. I vetmi informacion i gjetur në faqen e internetit janë raportet e vlerësimeve të jashem për pese programe studimi të akredituara vitin e fundit.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>NJSBCZHK harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së cdo programi. Përveç NJSBCZHK, në këtë analize merr pjesë dhe stafi drejtues i njësisë bazë si dhe stafi në rang fakulteti;</p> <p>Me anë të NJSBCZHK, institucioni harton politika që synojnë</p>

dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	përmirësimin e programit të masterit profesional. Çdo instrument vlerësimi I përdorur në rang individual/programi/institucioni shërben për identifikimin e problematikave dhe përmirësimin e situatës.
--	--

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional në vitin 2017;</p> <p>Institucioni plotëson të gjitha kërkesat ligjore në lidhje me sigurimin e cilësisë. Gjithashtu UMSH përdor instrumente mjaft efikase dhe të përshtatshme për sigurimin e cilësisë në programet e studimit;</p> <p>NJSBCZHK ka hartuar procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve në programin në fjalë. Gjatë vizitës na u vunë në dispozicion disa formularë të ndryshëm të cilat shërbenin si pjesë procedurale e matjes dhe vlerësimit të cilësisë, megjithatë grupi i vlerësimit të jashtëm sugjeron që çdo formë të jetë e regjistruar me një numër ISO pasi ky lloj sistemi do të siguronte me efikasitet mbarvajtjen e standardeve të dokumentacionit;</p> <p>Të gjithë mekanizmat e përdorur për sigurimin e cilësisë janë të aplikueshme gjatë procesit mësimor, në bazë semestrale ose vjetore. Pra mbikëqyrja është e herëpashershme për programin e studimit;</p> <p>NJSBCZHK por jo vetëm, synon ndërgjegjësimin e personelit në lidhje me sigurimin e cilësisë, e cila lidhet drejtë për se drejtë dhe me vlerësimin nga ana monetare dhe jo-monetare e vetë stafit. Gjithashtu NJSBCZHK bën të mundur edhe ndërgjegjësimin e studentëve për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e saj dhe njofton ata në lidhje me kërkesat që vijnë nga ASCAL;</p> <p>Institucioni në planin strategjik 2018-2023 ka parashtruar një strategji të detajuar në lidhje me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë (Objektivi 2, fq. 10-12). NJSBCZHK ka riorganizuar më së fundmi disa mënyra vlerësimi edhe në rang programi.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

- Siç u tha dhe mësipër, me anë të NJSBCZHK, institucioni i kushton vëmendje sigurimit të brendshëm të cilësisë duke përdorur elementë të ndryshëm vlerësimi. Të gjitha këto instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit të studimit bëjnë të mundur identifikimin e problemeve të mundshme.
- Si stafi akademik, po ashtu dhe studentët janë të vetëdijshëm për proceset e vlerësimit dhe angazhimi i tyre rezultojnë të jetë I një rëndësie të veçantë. Vlerësimet janë gjetje përgjatë gjithë vitit akademik dhe përfundimet u shpallen të gjithë stafit në mënyrë konfidenciale si dhe strukturave drejtuese.
- Grupi i vlerësimit të jashtëm sugjeron përdorimin e standardeve ISO që ka të bëjë me cilësinë e dokumentacionit si dhe publikimin e informacioneve që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë në realizimin e programit të studimit, si psh. Strategjitë, politika, procedurat, gjetje jo-konfidenciale, etj.

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i Studimit Master Profesional në Administrim Biznesi është një program 2-vjecar, në përfundim të të cilit studentët duhet të përftojnë 120 ECTS. Qëllimi i këtij programi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve në fushën e administrimit të biznesit. Ky program është hartuar duke u bazuar edhe te kërkesat e tregut të punës, gjë e cila ndihmon në adresimin me efikasitet të përmbushjeve të nevojave në tregun e punës. Programi i studimit ka ndërthurur lëndë të ndryshme të manaxhimit, marketingut, financë-kontabilitetit, ekonomiksit si dhe teknologjisë së informacionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i Studimit Master Profesional në Administrim Biznes është hapur në bazë të Urdhërit 482, datë 03.10.2011 të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe është akredituar për here të parë në bazë të Urdhërit Nr. 291, datë 11.07.2012 të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. Sipas kërkesave ligjore, VKM Nr. 41/2018, ky program është riorganizuar, duke kaluar në kohëzgjatje 2 vjecare, 120 ECTS, të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në datë 27.03.2018.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Organizimi i programit të studimit, realizohet me:


- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS ka 25 orë punë
- 1 orë mësimore ka 50 minuta

- Plan i mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabelat 11.1 dhe 11.2 te Planit në aneks)

Plan i mësimor është i ndarë në 2 vite akademike, në formën e moduleve. Vitin e parë studentët kanë të drejtë të ndjekin gjithsej 8 lëndë, nga të cilat njëra është me zgjedhje dhe 7 të tjerat të detyrueshme. Në vitin e dytë studentët ndjekin 4 lëndë (njëra është me zgjedhje), një praktikë dhe Provim Formimi ose Diplomë. Lëndët janë nga 7 ose 8 ECTS secila ndërsa praktika është 12 ECTS dhe Provim Formimi/Diploma ka gjithsej 18 ECTS.

- Mënyra e përcaktimit të 1 krediti (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 9-10 orë në auditor dhe 15-16 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret/Detyrat 11-12 orë në auditor dhe 13-14 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 23 orë në auditor dhe 2 orë punë e pavarur e studentit
- Punim Diplome/Provimi përfundimtar 3 orë në auditor dhe 22 orë punë e pavarur e studentit



Ndarja dhe përcaktimi i ECTS është bërë duke u bazuar në sistemin e Bolonjës. Programi është mëse mirë ideuar duke ofruar ngarkesat e duhura për orë mësimore si dhe për angazhimet e vetë studentëve.

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 11.1& 11.2dhe 12në Aneks)

Planet mësimore kanë patur ndryshime thelbësore duke u bazuar tek kërkesat ligjore, VKM Nr. 41/2018. Programi në fjalë ka kaluar në një proces riorganizimi. Nga 1.5 vite studimi ky program kaloi në 2 vite studimi, duke u shtuar kështu 30 ECTS të tjera.

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabelat 13 në Aneks)

Stafi i angazhuar në mësimdhënie është i mirëpërgatitur dhe fusha e ekspertizës është e përshtatshme me lëndët që ato drejtojnë. Një nga pikat më të forta të këtij institucioni është pikërisht stafi me eksperiencë i cili u ofron studentëve mundësinë e thellimeve të tyre në fushën përkatëse.

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

- Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset janë të detajura dhe shpjegojnë qartazi gjithcka përmban një seancë leksioni. Aty shpjegohen qartë dhe kriteret e vlerësimit si dhe literatura që studentet duhet të lexojnë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Duke u bazuar në kërkesat ligjore, VKM Nr. 41/2018, ky program është riorganizuar (duke kaluar në kohezgjatje 2 vjecare, 120 ECTS), të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise, në datë 27.03.2018;</p> <p>Ky program mbështetet totalisht në Sistemin European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në fund të të cilit çdo student duhet të përmbushë 120 kredite (60 kredite për çdo vit akademik).</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi është në përputhje me strategjitë e zhvillimit të institucionit si dhe me kërkesat ligjore për “Master Profesional”. Programi synon ti pajisë studentët me njohuri praktike në fushën e adminstrim biznesit;</p> <p>Ky program synon ngritjen mbi njohuritë e nivelit Bachelor. Lëndët në kurrikulën përkatëse si dhe tematikat e silabuseve e tregojnë më së miri përfaqshjen e programit të hartuar për të zhvilluar më tej karrierën profesionale të studentëve;</p> <p>Nuk i përket vlerësimit të këtij programi;</p> <p>Programi ka si mision pajisjen e studentëve me kompetenca dhe njohuri profesionale që bejnë të mundur zhvillimin e tyre si ekspertë dhe specialist të fushës së studimit;</p> <p>Nuk i përket vlerësimit të këtij programi;</p> <p>Programi Master Profesional në Administrim Biznes ka objektiva të qarta. Fokusi i këtij programi janë studentët që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve në Administrim Biznes. Gjithashtu ky program është në përpuethshmëri edhe me individeë të punësuar në institucione private dhe/ose publike që ju nevojiten njohuri praktike në fushën e administrimit të biznesit.</p>
--	---

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

<p>Kriteri 1 Përbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodët e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Përbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve është në përpuethshmëri me arritjen e qëllimeve të tyre dhe është i përshtatshëm për programin që ofrohet. Syllabusët janë mjaft të detajuara dhe në përgjithësi ato janë në përshtatshëm me programin e studimit;</p> <p>Syllabusët përcaktojnë qartë formatin e vlerësimit, i cili përfshin: 60 % provimin përfundimtar, pjesa tjetër 40 % shpërndahet në provim të pjesshëm, detyra kursi dhe/ose pjesëmarrja në diskutime.</p>
--	---

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Stafit akademik në këtë program studimi, si ato me një përvojë disavjeçare dhe ato me një experience ndërkombëtare, bëjnë të mundur ecurinë dhe zhvillimin me tej të këtij programi;</p> <p>Siç u tha dhe më sipër, ky program mbështetet në sistemin e Bolognes duke përdorur ECTS, që bejnë të mundur transferimin e krediteve të përftuara. Megjithatë një nga barrierat e këtij programi është që programi behet në shqip, ndaj ndërkombëtarizimi i tij (programet e shkëmbimit, shkëmbimet e profesorëve të huaj, etj.) është i vështirë. Grupi i jashtëm i vlerësimit sugjeron që këtij programi ti shtohet dhe një lëndë e profilit, si psh. “Business English”. Kjo lëndë do ishte një element mjaft i rëndësishëm dhe baza për ndërtimin e</p>
---	--

	<p>urave lidhëse të këtij programi dhe në nivel ndërkombëtar;</p> <p>Për shkak të barrierave gjuhësore, për momentin ky program nuk ka elemente konkrete të ndërkombëtarizimit. Megjithatë universiteti është në hapat e parë të bisedimeve për një bashkëpunim të mundshëm me universitetin Lodz në Poloni.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi Master Profesional në Administrim Biznes përfshin aftësimin profesional i cili bazohet në leksionet dhe në praktikat profesionale dhe njëkohsisht, për studentët që kërkojnë të zhvillojnë kërkimin shkencor, ato kanë të drejtë të përgatisin një temë diplome në fund të studimeve të tyre;</p> <p>Ky program është në një linjë me profilin e UMSH si dhe me strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Duke u bazuar dhe tek CV e personelit akademik, vihet re se ata janë të përfshirë në punë kërkimore (konferenca, publikime) dhe projekte të ndryshme;</p> <p>E gjithë puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit është në një linjë me objektivat dhe synimet e vetë programit.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Hapja e këtij programi është bërë në bazë të një analize të nevojave të tregut të punës. Duke qenë se dhe përqsja e këtij programi është të përgatisë profesioniste në fushën e administrim biznesit, mund të thuhet se ky program është në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Ashtu siç u tha më sipër, ky program u ideua në bazë të një analize të nevojave të tregut të punës. Lëndët e programit janë të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe ofrojnë një gamë të gjerë aspektesh të prekur;</p> <p>Analiza e nevojave të tregut të punës e performuar nga insitucioni përfshin një analizë kërkesë dhe ofertë për programet e propozuara. Mund të thuhet që kjo analizë nuk përfshin shumë detaje por ofron një këndvështrim të përgjithshëm. (Aneksi 8, i bashkangjitur RVB)</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Përveç se ky program nuk bien ndesh me interesat kombëtare, ky program ndihmon në zhvillimin mëtej të ekspertëve dhe specialistëve të fushës përkatëse;</p> <p>Ky program studimi nuk ka si objektiv të veçantë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>

Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	N/A
Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	Sipas kërkesave ligjore, VKM Nr. 41/2018, ky program është riorganizuar (duke kaluar në kohëzgjatje 2 vjecare, 120 ECTS), të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise, në date 27.03.2018.
Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	N/A
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;	Faqja zyrtare e UMSH përmban vetem emrin e programit që ofrohet dhe nuk jep asnjë detaj tjetër në lidhje me kohëzgjatjen e programit, me lëndët e tij si dhe me oraret e leksioneve. Studentët e interesuar duhet të marrin informacion duke kontaktuar drejtë për së drejti departamentin që ofron këtë program. Ndërkohë që studentët e regjistruar njoftohen për detajet e syllabuseve gjatë orëve të para të leksioneve. Grupi i vlerësimit të jashtëm sugjeron që institucioni duhet të ofrojë publikimin e detajuar të programit mësimor, ku të shfaqen të gjithë lëndët bashkë me brendësinë e tyre.
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;	Ky program paraqet qartë strukturën studimore për çdo semestër ku parashikohen dhe detyrimet e studentit që duhet të përmbushë për të arritur në nivel diplomimi. Në fund të periudhës normale, 2-vjecare, studentët mund të futen me Provim Formimi ose të përgatisin Diplomë;
Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	
Nuk i përket vlerësimit të këtij programi.	
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ul style="list-style-type: none"> - Në vitin 2015 UMSH hartoi një analizë të nevojave të tregut të punës, ku bazon dhe hapjen e Programit Profesional në Adminstrim Biznesi, i cili synon ngritjen mbi njohuritë e nivelit bachelor, i cili ka arritur të ndërtojë një kurrikul të hartuar për të zhvilluar më tej karrierën profesionale të studentëve të këtij programi. - Duke u bazuar në kërkesat ligjore, VKM Nr. 41/2018, ky program është riorganizuar (duke kaluar në kohëzgjatje 2 vjecare, 120 ECTS), të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise, në date 27.03.2018. Kalimi nga 1.5-vjet në 2-vjet ka bërë të mundur një rishikim dhe riorganizim më rigoroz të kurrikulës dhe të syllabuseve në vecanti. - Programi është i mirëndërtuar dhe shpërndarja e krediteve është mëse i pranueshëm. Staf i është përgatitur dhe ka fushën e përshtatshme të ekspertizës për lëndet që drejton. Gjithashtu lëndët janë të 	

mirë-përgjedhura dhe në linjë me programin e studimit.

Duke vlerësuar programin dhe lëndët e ofruara, grupi i vlerësimit të jashtëm sugjeron:

1. *Ndërkombëtarizimin e programit. Një nga elementët fillestare mund të jetë shtimi i një lënde të re (e detyruar) si "Business English" ose një lënde tjetër alternative, e cila do të ndihmojë në rritjen e kapaciteteve gjuhësore si dhe në mundësinë e studentëve për të qenë pjesë e programeve të shkëmbimit që mund të ofrohen në të ardhmen;*
2. *Shtimi i lëndëve me zgjedhje, të paktën një lënde me zgjedhje për çdo semester. Duke qenë se studentët janë të profiëve të ndryshme, dhe jo vetëm të diplomuar në nivelin bachelor Administrim Biznes, do ishte më mirë që ato të kishin disa lëndë në lidhje me fushat e tyre të interesit.*
3. *Institucioni duhet të marrë masa të publikojë të gjithë programin e studimit bashkë me syllabuset përkatëse në faqen zyrtare të tij. Kjo do të ndihmojë në informimin më efikas të të interesuarve për këtë program studimi.*

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

PS MPAB 120 ECTS përmban disiplina formuese, karakterizuese, integruese, plotësuese/me zgjedhje. Ai mbështetet dhe integron njohuri të përfituara nga studentët në ciklin paraardhës. Procesi i mësimdhënies në auditor realizohet në bazë grupi leksioni dhe seminari; format e mësimdhënies të përdorura janë: leksione, seminare, praktika profesionale dhe orët e konsultimit. Organizimi i mësimimit me shembuj, ushtrime, detyra kursi, etj vlerësohet si "shumë e mirë" nga studentët e këtij PS të intervistuar nga GVJ.

Në përputhje me karakterin aplikativ të programit dhe lëndëve që ai përfshin, në orët në auditor synohet trajtimi i situatave konkrete dhe sjellja e shembujve nga bizneset shqiptare. Në procesin e mësimdhënies përdoren projektorë, kompjutera, etj. Organizimi i orës së mësimimit i përshtatet natyrës së lëndës dhe synon angazhimin e të gjithë studentëve për një mësimnxënie optimale.

Kriteret më kryesore në planifikimin e procesit mësimor të PS përcaktohen në Rregulloren e brendshme të UMSH dhe përfshijnë: zhvillimin e lëndës sipas syllabuseve si dhe balancimin e ngarkesës mësimore si për studentët ashtu dhe për personelin akademik.

Në orët e seminareve pedagogët bëjnë vlerësimin e përgjithshëm dhe individual të dijeve të studentëve; kjo formë vlerësimi ndikon në vlerësimin përfundimtar dhe ndihmon pedagogun të kuptojë se ku duhet punuar më mirë. Kontrolli i njohurive të studentëve sipas Rregulloreve të UMSH realizohet nëpërmjet: (1) angazhimit në diskutime gjatë seminareve dhe me detyra të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës, (2) detyrave të kursit për problematikën e disiplinës (3) provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara gjatë trajtimit të lëndës. Për çdo modul/lëndë, mënyra e kontrollit të njohurive përcaktohet në syllabusin përkatës. Sistemi i vlerësimit të studentëve është i njëjtë për të gjitha programet në nivelin Master dhe realizohet nëpërmjet sistemit të pikëve 0-100 të cilat konvertohen në nota (4-10).

PS synon nxitjen e punës së pavarur të studentëve. Studentët e MPAB 120 ECTS janë përfshirë në Panairin e ideve, ku janë prezantuar punime të studentëve, të drejtuar nga pedagogë të lëndëve.

Për vlerësimin e brendshëm të mësimdhënies UMSH ka caktuar Njësinë e sigurimit të cilësisë (një nga detyrat e kësaj njësie është edhe kjo). Sipas rregullimeve të brendshme, të shoqëruara me dokumenta *tip*, studenti vlerëson edhe pedagogun, edhe lëndën. Në vitin akademik 2018-19, në procedurë është futur edhe fokus grupi (FG) simënyrë e mbledhjes së informacionit për këtë qëllim. Një intervistë e strukturuar, e miratuar në Rektoratën e UMSH, është instrumenti që përdoret në FG. Për PS MPAB 120 ECTS në periudhën prill-maj

është organizuar një FG me studentë të këtij PS. Nga ana e Njesisë së sigurimit të cilësisë, janë angazhuar në realizimin e FG anëtarë të njesisë, që janë në moshë të re për të garantuar një mjedis sa më miqësor gjatë intervistës. Dokumentacioni/informacioni i mbledhur është vënë në *share folder* për të lehtësuar komunikimin e palëve të përfshira në këtë vlerësim.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela 14 në aneks):

Tabela 14 në RVJ tregon llojet e formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet e PS MPAB 120 ECTS. Shpërndarja është sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me qëllimet e programit.

Format e kontrollit të njohurive

Vlerësimi i studentëve bëhet sipas linjës së vlerësimit të vazhdueshëm dhe mban një proporcion të llogjikshëm midis punës që bëhet gjatë simestrit me dhe provimit përfundimtar. Shpërndarja e pikëve në përqindje sipas kategorive (pasqyruar në Tabelën 15 të RVJ) është: 30% provimi i ndërmjetëm dhe detyra në klasë (20+10), 10% prezenca në auditor, 60% provimi përfundimtar me shkrim.

Mënyra si është organizuar mësimi në auditor me 7 javë gjithsej një lëndë (enjte/shtunë ose premte/shtunë) nuk i jep shumë dorë studentit për të medituar e prodhuar, vecanërisht kur vjen nga formim bazë i fushave të tjera, konsideruar edhe faktin që ai është i punësuar. Por ky është një difekt i organizimit të studimeve master në rang vëndi.

Studentët e takuar nga GVJ u shprehën se do të preferonin një shpërndarje pikësh për vlerësimin e njohurive: 50% në auditor dhe 50% provimi përfundimtar, konsideruar gjithë llojet e detyrave që bëjnë në simestr në lëndë.

Aktivizimi i studentëve në aktivitetete njesisë

Departamenti aktivizon studentët në komponentë të ndryshëm të aktivitetit të njesisë (Për punime shkencore individuale të pedagogëve, Për projekte shkencore në rang Departamenti, Për projekte shkencore në rang Fakulteti, Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë, etj. (Tabela 16). Nuk mund të thuhet që të angazhuarit në këto kategori aktivitetesh janë nga PS MPAB 120 ECTS, si master me orientim të fortë profesional që është (dhe jo kërkimor). Gjithashtu studentë aktivizohen në Zyrën e karrierës dhe një student ishte pjesë e GVB.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Informacioni kryesor për këtë rubrikë, vec leximit të materialeve të ofruara nga institucioni në paketën për ASCAL, u mblodh nga GVJ nëpërmjet intervistave gjysëm të strukturuar të zhvilluara gjatë takimeve me grupet e interesit, dhe vecanërisht për këtë rubrikë, me GVB, me studentët, me drejtuesen e Departamentit të ekonomisë.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

UMSH ndjek një politikë të përcaktuar qartë për pranimin e studentëve në programet e studimit që ofron në ciklin e dytë. PS MPAB 120 ECTS mund ta ndjekin studentë nga universitetet shqiptare (publike e private) dhe

nga vende të tjera shqipfolëse, të cilët zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 ECTS.

Në këtë PS mund të pranohen pa nevojë për plotësim kreditesh studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në shkenca ekonomike apo profile të ngjashme në UMSH apo në Universitete të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë në përputhje me kriteret e njehsimit të diplomave.

Procesi i pranimit të studentëve në MPAB 120 ECTS fillon me ekuivalentimin e diplomës nga komisioni i ngritur nga Dekanati dhe miratuar nga Rektori. Në këtë procedurë përfshihet edhe përcaktimi i debiteve formuese që studenti duhet të plotësojë para hyrjes në programin e studimit. Procedurat e pranimit përcaktohen në aktet rregullatore të institucionit, përfshirë rregulloren e PS MPAB.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit të studentëve të rinj realizohen nga një komision i veçantë pedagogësh duke marrë parasysh vit pas viti përcaktimet bazë ligjore të shpallura nga Ministria e arsimit për dhe kritere të veçanta që vendos vetë institucioni.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Në kriteret që ka vendosur UMSH për renditjen dhe pranimin zënë vend nota mesatare e ciklit paraardhës, eksperiencat e punës dhe rezultatet e lëndëve që i takojnë programit të zgjedhur.

Kandidati që kërkon të ndjekë studimet në Masterin Profesional në Administrim Biznesi duhet të dorëzojë pranë Departamentit Ekonomisë për konkurim dokumentacionin e përcaktuar, që evidentohet në faqen zyrtare të UMSH (<http://umsh.edu.al/announcements#undefined7>). Sekretaria mësimorë luan një rol të rëndësishëm në verifikimin e vlefshmërisë së dokumentave të paraqitura për regjistrim.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Tabela 17 ne aneks):

PS MPAB 120 ECTS u hap në vitin 2017-18. Të regjistruarit në atë vit e në vazhdim, dhe nota mesatare e tyre janë si në tabelen 17. Vihet re një ngritje e lehtë e notës mesatare në hyrje në pranimet (nga 6,3 në 6,5). Numri i regjistrimeve është afërsisht i njëjtë(57, 56/vit).

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare (Tabela 18)

PS MPAB 120 ECTS zgjat 2 vite akademike. Të regjistruarit e parë në këtë PS janë në vitin akademik 2017-18. Të diplomuarit e parë pritet të dalin në fund të vitit akademik 2018-19. Ky raport u shkrua në simestrin e dytë të vitit akademik 2018-19. Nga takimi me padagogët, raportohet kalueshmëria 60% dhe rritja e notës mesatare në dalje (prishmëri) me afërsisht 2 nota. Kjo ngritje vjen kryesisht nga karakteri aplikativ që i është dhënë dijeve në këtë program.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe me Rregulloren të UMSH, institucioni lejon mobilitetin e studentëve në të dy kahet. Transferimi kryhet nëpërmjet sistemit të krediteve ECTS, para fillimit të vitit akademik dhe me procedura të përcaktuara. Në këtë proces merr pjesë edhe Departamenti si një aktor kryesor. Nuk ka transferime në PS MPAB 120 ECTS. Institucioni po punon për një projekt me Poloninë për njohje të programeve të lëndëve të vecanta.

Të dhëna për punësimin e studentëve dhe mësimi

Ky është një program që synon studentë të punësuar dhe oraret në auditor janë përshtatur me këtë (në një, premtë, shtunë).

Për punësimin e studentëve institucioni organizon leksione të hapura me kompani e agjenci.

Të pyetur për çfarë do ta përdorin diplomën, përgjigjet e studentëve të këtij PS ishin mikse (Për rritje personale, për punësim, për asgjë). Në sekretarinë mësimore personeli i punësuar është nga ish studentë të UMSH.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Të dhënat për këtë rubrikë u mbledhën nga takimi me:

Takim me grup studentësh të PS MPAB 120 ECTS (1 nga viti II, 3 nga viti I i studimeve të PS).

Takim me sekretarinë mësimore.

Takim me pedagogët/Takim me Departamentin e Ekonomisë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimi të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimi dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimi.</p>	<p>Studentët që ndjekin PS MPAB 120 ECTS mund të regjistrohen në këtë PS vetëm me diplomë të nivelit paraardhës të studimeve, ose të tjera të ekuivalentuara me të që plotësojnë kriterin e krediteve në kufirin 180ECTS ose më lart.</p> <p>Pranimi në këtë PS bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me rregulloret e institucionit.</p> <p>Sipas kriterëve të institucionit, grupi aktual i studentëve në PS MPAB 120 ECTS rezulton miks nga pikpamja e eksperiencave të punës. Përzgjedhja e tyre ka patur një koeficient prej 20% për vlerësimin e eksperiencës në punë. Kjo, sipas takimit me studentë të PS rezulton në disa raste "disavantazhuese" në auditor për studentët të cilët nuk kanë eksperiencë dhe vinë direkt nga bachelori. Grupet mikse kanë vlerën e vet në pasurimin e orës së mësimi, por mund të shkaktojnë edhe difekte në disa plane (lloji i ushtrimeve që zhvillohen në disa lëndë nuk përshtatet gjithmonë njëkohësisht për të dyja kategoritë e studentëve-kërkohen ushtrime të ndryshme; pjesmarrja e studentëve me diskutime në auditor me shembuj konkretë nga eksperiencia nuk është njësoj e suksesshme për njërin katogori, etj).</p> <p>Nuk jepet provimi i gjuhës se huaj për masterin profesional sipas Ligjit.</p> <p>Pikërisht kriteret e pranimi në PS MPAB 120 ECTS janë krijuar pas një arsytimi të thelluar të drejtuesve të institucionit mbi qëllimin/vizionin e këtij masteri që hyri si kërkesë e Ligjit, por u zbatua në praktikë pas një pune të vëmendshme për të kuptuar tendencat e tregut.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të</p>	<p>Studentët që nuk janë të punësuar, sqarohen nga pedagogët e caktuar për këtë qëllim mbi pritshmëritë e tyre në program dhe mundësi punësimi potenciale. Koordinator i masterit kujdeset jo vetëm që të shpërndahen në praktika, por edhe mundësitë që të këtë</p>

<p>studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>punësim pas kësaj periudhe. Disa shembuj sukcesi u treguan nga pedagogët për PS MPAB 90 ECTS.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe e Karrierës orientojnë dhe këshillojnë studentët mbi kërkesat e tregut të punës, mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës, në sektorin publik dhe privat, si dhe në tregjet rajonale dhe më gjerë, sipas mundësive. Studentët e takuar me GVJ nuk kishin kontaktuar ndonjëherë me këtë zyrë; dinin për egzistencën e saj dhe do të shkonin në fund të programit.</p> <p>Studentëve u jepet informacion mbi statusin e institucionit dhe të PS në lidhje me akreditimin dhe njohjen e diplomës në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Ky informacion duhet të bëhet publik nga institucioni në adresën elektronike www.umsh.edu.al – Sigurimi i cilesise.</p> <p>Këshillimi i karrierës kryhet nga Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës. Aty angazhohen personel akademik, studentë dhe palë të tjera. Kjo drejton dhe mbështet studentët gjatë procesit të formimit universitar të tyre, si dhe orienton dhe këshillon ata mbi kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë e zgjedhjes së ps të niveleve më të larta.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Për PS MPAB 120 ECTS u panë regjistrat e amzës në sekretarinë mësimore si dhe regjistrat mësimorë të lëndëve me mungesat gjatë simestrit. Mund të themi që institucioni disponon të dhëna në vazhdimësi për studentët që nga regjistrimi për këtë PS.</p> <p>Në sekretarinë mësimore mbahen statistika vjetore për numrin e të diplomuarve përtë gjitha programet që ofrohen nga UMSH.</p> <p>GVB ofroi statistikat vjetore për regjistrimet në PS MPAB 90 ECTS DHE PS MPAB 120 ECTS, notat mesatare vjetore në hyrje për cdo vit dhe transferimin për brezat. Këto paraqiten në Aneksë të RVJ, Tabela 11.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna në vazhdimësi për ecurinë akademike të studentëve, për notën në hyrje, progresin sipas lëndëve, përgatitjen për provimin final. Sistemi elektronik ndihmon edhe studentët që të informohen në kohë për ecurinë sipas kritereve të vlerësimit për rubrika të parashikuara në program, dhe numrin e mungesave.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në</p>	<p>PS MPAB është në vitin e dytë. Akoma nuk ka nxjerrë të diplomuarit e parë. Nuk ka një bazë të dhënash akoma për punësim pas diplomimit për PS MPAB 120 ECTS.</p> <p>Mbajtja e të dhënave për studentët pas diplomimit në UMSH bëhet nga Zyra e këshillimit të studentëve dhe karrierës. Gjithashtu departamenti që mbulon programin përkatës mban sipas mundësisë</p>

<p>ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>lidhje me të diplomuarit me qëllim shfrytëzimin e këndvështrimit të tyre për përmirësime të mundshme të ps.</p> <p>Në RVB thuhet që kjo gjë është bërë me të diplomuarit në MPAB 90 ECTS. GVJ ju vu në dispozicion edhe një tabelë me të dhëna për punësim të studentëve të diplomuar në MPAB 90 ECTS sipas viteve, në përputhje me diplomën/jo në përputhje me diplomën. Kjo është vendosur në Anekse të RVJ, Tabela 17.</p> <p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për krijimin dhe mbajtjen e një baze të dhënash të hollësishme që e shoqëron studentin që në pranimin e tij deri në diplomim. Aktet rregullatore të UMSH përcaktojnë mënyrën e realizimit të kësaj detyre. Një sistem elektronik funksionon prej 3 vitesh në ndihmë të këtij procesi. Këto mundësojnë bazën e të dhënave për studentët që vazhdojnë studimet në nivelet më të larta brenda UMSH.</p>
---	--

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Në RVB thuhet që: Informacioni për PS, afatet/kalendaret, statusin e akreditimit, dhe organizimin ju vihet në dispozicion studentëve në portalin e institucionit. Nga verifikimi i GVJ konstatohet se informacioni në faqen elektronike/portalin duhet të jetë më i plotë, për të dhënë mundësi për vlerësim të pavarur nga cilido përdorues i interesuar/ student potencial.</p> <p>Nga takimet e me grupet e interesit, u kuptua që Sekretaria mësimore, departamenti, koordinatorët, tutorët akademikë dhe tutoriatet janë nyje që kujdesen për përhapjen e këtyre informacioneve.</p> <p>Pedagogët që zhvillojnë lëndët informojnë studentët për programin e lëndës, detyrimet akademike, metodat e vlerësimit, dhe rezultatet në secilën rubrikë të vlerësimit të vazhdueshëm. Rezultatet hidhen edhe në sistemin elektronik, sipas rregulloreve përkatëse të PS dhe të institucionit.</p> <p>Forma kryesore përfundimtare e kontrollit të dijës është provimi që zë 60% të notës. Mënyra e hartimit të tezës së provimit është e përcaktuar me udhëzim të posaçëm dhe mundëson vlerësim objektiv e të barabartë të studentëve për përvetësimin e njohurive. Vlerësimin e provimit bëhet me pikë që konvertohen në notë. Studenti ka të drejtë të njihet paraprakisht me vlerësimin nga ana e komisionit të provimit, përpara se të regjistrohet rezultati përfundimtar i provimit nga sekretaria mësimore, sipas përcaktimit në aktet rregullative të UMSH, konkretizuar në Udhëzuesin për studentët. Pashpalljessë rezultatit përfundimtar të provimit, nëse studentinuk është dakord me vlerësimin, katë drejtë të bëjë ankesë meshkrim, që dorëzohet në sekretarinë mësimore të fakultetit dhe ndiqet nga njësi përgjegjëse deri në sqarimin e studentit.</p>
---	---

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p>	<p>Tutorët akademikë dhe procesi i tutoriateve janë krijuar në UMSH si valvola për të drejtuar informacionin dhe këshillimin në të dyja kahet për zgjidhjen e problemeve të studentëve në lidhje me</p>
---	---

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

procesin mësimor. Tutoriati funksionon me persona nga PA të cilët sipas një kalendari të paracaktuar, me rregullore të posacme mbledhin kërkesa për probleme të studentëve sipas dokumentave tip të miratuara nga institucioni, këshillojnë ata mbi rrugët e trajtimit dhe personat që duhen kontaktuar dhe nga ana tjetër informojnë PA përkatës mbi çështjen. Autoriteti i tutorëve është i padiskutueshëm në të dyja kahet dhe si i tillë, i njohur në stukturat e komunikimit të institucionit.

Institucioni kushton vëmendje të posacme organizimit të punës për kryerjen e praktikës mësimore në PS MPAB 120 ECTS. Puna përgatitore është e organizuar me afate, me procedura të paracaktuara dhe dokumenta tip që duhet të plotësohen, me persona që kanë përgjegjësinë për të kryer këto procese. Institucioni ka një udhëzues për praktikën ku sqarohen këto.

Institucioni ka marrëveshje me aktivitete private/publike ku studentët e këtij PS mund të kryejnë praktikën. Studentët që janë në punë kanë të drejtë të zgjedhin nëse do ta bëjnë praktikën profesionale pranë organizatës ku janë të punësuar, ose gjetkë.

Këtë aktivitet për këtë PS e drejton Departamenti i ekonomisë, mbështetur nga Dekanati i FSHE.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni informon studentët në mënyrë të hollësishme e të vazhduar mbi gjithë llojet e informacioneve të nevojshme në lidhje me Institucionin, PS, politikat e punësimit, etj. Ai ka vënë në dispozicion të këtij procesi njësi të caktuara organizative dhe ka krijuar procedura që ky informim të mos jete spontan.
2. Institucioni mban një bazë të detajuar të dhënash për studentët që nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve, përparimin e tyre akademik, etj.
3. Institucioni ka krijuar struktura për ndjekjen e studentëve pas diplomimit dhe krijimin e një baze të dhënash për këtë.
4. Institucioni ka angazhuar personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve në çështje akademike dhe të praktikave profesionale.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Bazuar në RVB, në takimin me stafin akademik si dhe me përfaqësuesit e Qendrës Kërkimore Shkencore, UMSH i kushton rëndësi kërkimit shkencor si dhe matjen e rezultateve të këtyre kërkimeve. Departamenti organizon prezantime mes kolegësh, ku shpalosen dhe diskutohen gjetjet e punimeve, mbështet stafin financiarisht për pjesëmarrje në konferenca të ndryshme, shtyn stafin të marrë pjesë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabelat 19 dhe 20 në aneks)

Institucioni ka një sërëaktivitetesh shkencore si botime të ndryshme, studime, projekte, etj. Të dhënat e detajuara janë paraqitur në tabelën 19.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Në çdo fillim viti akademik, personeli akademik paraqet planet në lidhje me publikimet e artikujve si dhe punët e tjera shkencore që i do të angazhohet. Ky planifikim ndihmon të bëjë të mundur dhe parashikimin e mëtejshëm të mbështetjes financiare që jep vetë institucioni;</p> <p>Stafi i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi është i përfshirë në projekte kërkimore që kanë të bëjnë me fushën e programit të studimit. Kjo ndihmon ndërthurjen e pjesës teorike dhe atë praktike gjatë leksioneve.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Ky program nuk ofron lëndë në gjuhë të huaj. Megjithatë një pjesë e mirë e stafit është diplomuar jashtë ose ka njohuri të avancuar të gjuhës angleze/franceze, gjë e cila ndihmon në përdorimin e një literature më të gjerë për të ardhur në ndihmë punimeve të vetë stafit.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Universiteti në rang departamenti ose fakulteti organizon takime të ndryshme ku prezantohen në veçanti punimet dhe gjetjet e doktoraturave. Stafi akademik merr pjesë dhe në trajnime të ndryshme që janë pjesë e projekteve të ndryshme;</p> <p>UMSH ndjek politika mbështetëse për studentët e doktoraturave dhe stafin që do të marrë pjesë në konferenca jashtë vendit. Studentët e doktoraturave janë më pak të ngarkuar nga ana mësimore pasi atyre ju jepet mundësia të kenë më tepër kohë për përfundimin me sukses të tezave të tyre. Gjithashtu, institucioni mbështet me një financim të plotë ose të pjesshëm stafin që paraqet kërkesë për mbështetje në konferencat shkencore.</p>
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program</p>	<p>Stafi akademik është i detyruar të dorëzojë një planifikim vjetor në lidhje me punët shkencore që ai do të ndërmarrë gjatë atij viti akademik. Njëkohësisht, ai është i detyruar të deklarojë të gjitha pjesëmarrjet dhe publikimet që ka bërë në fund të atij viti pasi gjithçka reflektohet në vlerësimin e kërkimit shkencor individual</p>

studimi;	dhe që reflekton edhe në kontratën për vitin pasardhës. Gjithashtu biblioteka përmban tekste dhe libra të profesorëve të vetë institucionit. Institucioni bën njoftime herë pas here dhe në faqen zyrtare në lidhje me ecurinë dhe eventet në kuadër të projekteve ndërkombëtare.
----------	---

Konkluzionet e vlerësimit:

- Stafit akademik është i përfshirë në kërkimin shkencor, gjë e cila u konstatua dhe nga CV e tyre si dhe nga takime të ndryshme që grupi i vlerësimit të jashtëm kishte gjatë vizitës në institucion.
- UMSH ka një strategji të qartë të kërkimit shkencor dhe përpiqet ti ofrojë stafit instrumenta ndihmëse për rritjen dhe zhvillimin profesional. Njëkohësisht institucioni ofron mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca, trajnime dhe aktivitete të tjera akademike.
- Si hap i mëtejshëm, grupi i vlerësimit të jashtëm sugjeron rritjen e cilësisë së botimeve në revista me faktor impakti.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, me organizata qeveritare dhe profesionale dhe me komunitete të tjera të biznesit. Ndër marrëveshjet më të suksesshme të këtij institucioni janë ato me institucionet qeveritare dhe me komunitetet e biznesit që ndihmojnë studentët të ndjekin praktikat e tyre profesionale. Ndërkohë, marrëveshjet ndërkombëtare që institucioni ka nuk janë efektive për Programin Profesional të Administrimit të Biznesit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Tabela 20 në aneks)

UMSH tregon se ka disa bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare, megjithatë ky institucion nuk është mjaftueshëm i konsoliduar me mobilitetet e stafit dhe të studentëve. Gjithashtu, numri i prezantimeve shkencore rezulton të jetë i ulët në vitet e fundit.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 21 në aneks)

Një nga pikat më të forta të UMSH pa dyshim janë dhe marrëveshjet me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit dhe tregun e punës, të cilat janë të një rëndësie të veçantë për mbarvajtjen dhe organizimin e programit të Masterit Profesional të Administrimit të Biznesit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve	Institucioni siguron që të gjithë studentët të kryejnë praktikat profesionale. Ata mund të përgjedhin institucionet ku ata

<p>“Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>punojnë, nëse janë të punësuar, ose bejnë aplikimet pranë departamentit dhe departamenti i ofron një mundësi praktike duke u bazuar tek marrëveshjet me institucionet e tjera. Këto praktika mund të jenë në institucione publike ose private në vartësi të kërkesave dhe mundësive që ofrohen. Stafit akademik bën ndjekjen hap pas hapi të të gjithë procedurave dhe kryerjes me sukses të këtyre praktikave;</p>
---	--

Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Ashtu siç u tha dhe tek kërkimi shkencor, stafit akademik është në bashkëpunim të vazhdueshëm. Gjatë takimeve me stafin akademik na u konfirmua që zakonisht pedagogët me eksperiencë shumëvjeçare janë të angazhuar në mbështetje të stafit më të ri të cilët kërkojnë të avancojnë dhe me titujt e tyre akademik. Në fund të çdo viti akademik ata vlerësohen për kontributin e tyre ndaj stafit të ri. Institucioni performon analiza të detajuara për çdo staf akademik në lidhje me shumë komponentë duke përfshirë dhe kërkimin shkencor.</p>
--	--

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkëpunim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Shihet qartë që institucioni ka realizuar disa marrëveshje me aktorë vendas të cilat dhe janë funksionale. Megjithatë për momentin nuk ka ndonjë marrëveshje konkrete me institucione të huaja që janë në ndihmë të procesit mësimor ose të praktikave profesionale në këtë program studimi;</p> <p>Departamenti ka angazhuar staf të posaçëm për mbarvajtjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. Të gjitha hapat dhe proceset janë të dokumentuara pranë departamentit;</p> <p>Trajnimet e vetme që bëhen dhe u identifikuan në këtë institucion janë ato në kuadër të projekteve. Ndërkohë grupi i vlerësimit të jashtëm sugjeron trajnime shtesë që kanë të bëjnë me metodat e reja të mësimdhënies, metoda kërkimore të avancuara, cilësia në IAL, etj. Këto trajnime do ndihmonin në rritjen më të shpejtë dhe në mënyrë më efektive të stafit akademik;</p> <p>Në rastet kur një marrëveshje me një palë të dytë është efektive, institucioni nënshkruan përsëri marrëveshje bashkëpunimi për një periudhë shtesë.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

UMSH ka arritur të ndërtojë ura lidhëse me institucionet publike dhe ato private që vijnë në ndihmë të praktikave profesionale, e cila është një nga elementet më të rëndësishëm për këtë program studimi.

Megjithatë pikë e dobët ngelet ndërkombëtarizimi dhe efikasiteti i bashkëpunimeve me institucione të Bashkimit Europian dhe më gjerë. Një element tjetër për tu përmirësuar është trajnimi i stafit në mënyrë periodike në tre elemente kryesore: mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe sigurimin e cilësisë.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Të shikohen në të ardhmen mundësitë e rritjes së numrit të pedagogëve me kohë të plotë dhe me grada e tituj shkencorë; **Rekomandimi është plotësuar plotësisht.**
- b) Të realizohet përmirësimi dhe azhurnimi i vazhdueshëm i programeve të këtyre profileve duke u bazuar në literaturat më bashkëkohore dhe të autorëve të njohur dhe botërorë; **Rekomandimi është plotësuar pjesërisht.**
- c) Të bëhet shumë promovim për tërheqjen në këto profile studimi të studentëve të rinj me rezultate të larta nga sistemi i studimit Bachelor, me qëllim që të investohet shumë tek ata dhe të bëhen në të ardhmen lidera përkatësisht në fushat e administrim biznesit dhe të administratës publike; **Rekomandimi është plotësuar plotësisht.**
- d) Të shihet mundësia që në simestrin e dytë të studimeve master të përfshihen të paktën dy lëndë me zgjedhje, praktikë e hasur në universitete të njohura botërore; **Rekomandimi është plotësuar plotësisht.**
- e) Të hartohet një plan i përgjithshëm strategjik 10-20 vjecar, dhe i detajuar në afatmesme dhe afatshkurtra për zhvillimin e institucionit dhe për të parashikuar ndryshimet e ndryshme që mund të ndodhin e për t'i bërë ballë konkurrencës së vazhdueshme nga universitete të tjera të vendit qofshin këto publike apo private; **Rekomandimi është plotësuar plotësisht.**
- f) Të sigurohet që studentet e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. **Rekomandimi është plotësuar plotësisht.**

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Ndërgjegjja organizative, krijimi i sistemeve të brendshme, kulturë e fortë organizative.
- 2) Orientimi i PS nga praktika (njohja e numrave dhe bashkimi i tyre në një logjikë operuese).
- 3) Publiciteti që i bëhet programit tek bizneset/organizatat.
- 4) Personeli akademik i PS i fokusuar në atë formë mësimdhënieje që është në përputhje me vizionin e PS.
- 5) Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet publike dhe ato private.

b. Pika të dobëta:

- 1) Ndërkombëtarizimi i programit është vlerësuar në nivele minimale. Mungojnë mundësitë e shkëmbimit të stafit dhe studenteve si dhe forma të tjera si ofrimi i një lënde të përgjithshme në gjuhën angleze.
- 2) Përdorimi i faqes zyrtare figuron i pamjaftueshëm. Institucioni ka mungesë informacioni në lidhje me programin e studimit dhe syllabuset.

c. Mundësitë:


- 1) Diferencimi i programit në lidhje me programet e tjera të profilit të Administrim Biznesit (të qënurit 120 ECTS dhe targetimi i studentëve me eksperience mund të jenë mundësi të këtij programi).
- 2) Bashkëpunime të mëtejshme të Institucionit me ekspertë të fushës së Administrim Biznesit.

d. Pengesat:

- 1) Nota mesatare e ulët në hyrje.
- 2) PS vetëm në gjuhën shqipe.
- 3) Grupi miks (direkt nga bachelor/ me eksperiencë në drejtim).

Rekomandime

1. Të vazhdojë të ruajë fokusin e PS MPAB 120 ECTS tek target grupi i synuar i studentëve me eksperiencë pune.
2. Të pasurojë faqen e internetit me informacione për PS që i japin mundësi një vlerësimi të pavarur nga cdo student potencial.
3. Të rrisë mundësitë e ndërkombëtarizimit në termat e mundësive të shkëmbimit, projekteve, diploma të përbashkëta, etj.
4. Të pasurojë bibliotekën me literaturën e fundit në lidhje me programin e studimit.



III. SUMMARY ANALYSIS OF THE EXTERNAL EVALUATORS BY THE SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).

A. STRENGTHS:

1. Organizational conscience, creation of internal systems, strong organizational culture.
2. Orientation of SP towards practice (recognition of numbers and their union in an operational logic).
3. Publicity of the program to businesses / organizations.
4. Academic staff focused on that teaching format that is consistent with the SP vision.
5. Cooperation agreements with public and private institutions.

B. WEAKNESSES:

1. Internationalization of the program is assessed at minimum levels. There is a lack of staff and student exchange opportunities.
2. The use of the official web site is insufficient. The institution lacks public information on the study program and syllabi.

C. OPPORTUNITIES:

1. Differentiating the program with other Business Administration profile programs (being 120 ECTS and targeting experienced students may present enormous enrolment opportunities for this program).
2. Further co-operation of the Institution with field experts in Business Administration.

D. THREATS:

1. Low average entry mark.
2. SP only in Albanian language.
3. Mix group of students (bachelor graduated without work experience and industry managers in the same class).

EXTERNAL EVALUATORS RECOMMEND:

1. *Maintain the focus of SP on a target group of students with experience in management.*
2. *Update the website with information necessary for independent evaluation by the potential student.*
3. *Increase the internationalization opportunities in terms of exchanges, projects, joint degrees, etc.*
4. *Enhance the library by buying latest books related to the study program.*

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. As. Dr. Eglantina Hysa

Prof. Dr. Mimoza Kasimati